



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA			
Pranuar me dt. Received on Priniljeno dana			
04, 03, 2022			
Org. Jed.	Numër Number Broj	Shtojca Appendix Prilog	Vlerë Amount Vrednost
01-052-7181/22			

# RAPORTI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2021

Klinë, shkurt 2022

## **Përmbajtja:**

1. Hyrje.....	3
2. Drejtoria e Administratës.....	4
3. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.....	14
4. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....	19
5. Drejtoria e Arsimit.....	24
6. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.....	32
7. Drejtoria e Inspektoratit.....	34
8. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.....	38
9. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	41
10. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.....	45
11. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	48

## 1. Hyrje

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Planit të Punës për vitin 2021, kam nderin që të paraqes raportin njëvjeçar të punës për periudhën 01 janar deri më 31 dhjetor 2021, i cili përfshinë punën njëvjeçare, të arriturat e komunës dhe vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit 2021.

Viti 2021 karakterizohet si viti me sfida shumë të mëdha, kur në mesin tonë ende është duke vazhduar edhe pandemia COVID-19, si dhe vërshimet e fundvitit 2020 dhe fillimit të vitit 2021, por pavarësisht kësaj për ekzekutivin është një vit i realizimit të synimeve dhe objektivave të planifikuara sipas ligjeve aplikative në fuqi, në përputhje me strategjinë zhvillimore dhe aktet e tjera valide për zhvillimin dhe funksionimin më të mirë për komunën tonë.

Kryetari i komunës gjatë vitit 2021 ka mbajtur edhe shumë dëgjime të rregullta më publikun si dhe 12 dëgjime për planifikimin buxhetor për vitin 2022 në qytet dhe në lokalitete të fshatrave në komunën e Klinës.

Gjatë vitit 2021 komuna ka pasur qëllimin e arritjes së këtyre objektivave:

- Administratë publike funksionale në shërbim të qytetarëve;
- Hapje e komunës ndaj qytetarëve;
- Avancimi i së drejtës për informim;
- Pjesëmarrje aktive e qytetarëve në vendimmarrje;
- Ruajtja e hapësirave publike;
- Avancimi i masave kundër ndotjes së ambientit;
- Mbrojtja e lumenjve dhe parqeve;
- Ngritja e kapaciteteve në infrastrukturë;
- Zhvillimi i bizneseve të vogla e të mesme dhe joshja e tyre për investime të reja;
- Rritja e prodhimeve vendore dhe subvencionimi në bujqësi;
- Ngritja e treguesve të cilësisë në shëndetësi, arsim, kulturë, rini e sport;
- Qasja në dokumente zyrtare;
- Llogaridhënia e zyrtarëve ndaj qytetarëve si dhe punë dhe aktivitete të tjera profesionale që dalin nga plani i punës i vitit 2021 dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Funksionim efikas të masave preventive për tejkalim të pandemisë COVID-19 në komunën tonë si çështja më primare gjatë viti 2021;
- Realizim të të gjitha projekteve të planifikuara.



## **2. DREJTORIA E ADMINISTRATËS**

Përmbledhje e raportit vjetor të punës për periudhën 01 janar deri më 31 dhjetor 2021, i cili përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare të Drejtorisë së Administratës dhe njëkohësisht vështirësitë më të cilat jemi përballur gjatë vitit 2021.

Me gjithë vështirësitë që kemi pasur, si shkak i pandemisë COVID-19, me angazhim është kemi arritur t'i realizojmë synimet dhe objektivat e parapara sipas ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar shumë të arritura dhe angazhime të administratës komunale, më qellim që të arrihen kushte sa më të mira për qytetarët e kësaj komune.

Administrata komunale gjatë vitit 2021 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale për qytetarët, në riorganizimin profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente me media, OJQ, shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare, duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim dhe qasje transparente më qytetarët.

Gjatë vitit 2021 komuna ka pasur qëllim të arritjes së këtyre objektivave:

- Administratë publike në shërbim të qytetarëve,
- Hapje e komunës për qytetarët,
- E drejta për t'u informuar, e cila është e drejtë e garantuar më ligj, e cila në komunën e Klinës zbatohet dhe respektohet,
- Kthimi i besimit të qytetarëve në institucionet publike përmes transparencës dhe qasjes së lehtë në shërbime komunale,
- Qytetarët të bëhen pjesë aktive e vendimeve të komunës,
- Klina më platformë digjitale për pjesëmarrje me publikun,
- Lajmërimi nga qytetarët për parregullsitë në çdo kohë dhe në çdo vend,
- Qasja në dokumentet zyrtare.

Prandaj, në pajtim të plotë më planin e veprimit për vitin 2021, besojmë që të gjitha obligimet që dalin nga këto plane dhe në përputhshmëri të plotë me ligjet aplikative në fuqi do t'i përmbushim edhe në vitin 2022.

Drejtoria e Administratës për vitit 2021 ka realizuar punët sipas planit të punës së drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarë, nga të gjitha zyrat me të cilat administrojnë. Gjatë vitit 2021 janë kryer punët si në vijim:

### **Spektori i Gjendjes Civile dhe Regjistrimit**

Nga sektori i gjendjes civile dhe regjistrimit në periudhën raportuese janë bërë 1.182 regjistrime të ndryshme: lindjes, martesë dhe vdekjes. Janë lëshuar gjithsej 37.106 lloje të certifikatave dhe akte tjera:

- Aplikacione për humbje të shtetësisë - 139;
- Taksa administrative - 38.302.00€.
- Aktvendime për regjistrim të mëvonshëm, korrigjime - 128

Nga e-kiosu i vendosur para objektit të komunës janë kryer gjithsej shërbime:

- Certifikata të lëshuara - 4719;



- Taksa të inkasuar - 4.720.30 €.

Janë inkasuar taksa administrative nga sektori i gjendjes civile gjithsej 43.720,30 euro.

### ***Projektet kapitale të përfunduara gjatë vitit 2021***

- Ndërtimi i ofiqarisë në Ujmirë
- Rinovimi i zyrës pritëse, digjitalizimi
- Rinovimi i objektit të komunës- nyjet sanitare dhe të tjera

### ***Zyra e prokurimit***

Puna e zyrës së prokurimit e themeluar në bazë të Ligjit të Prokurimit Publikë dhe organogramit të komunës, punën e vet e kryen bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik 04/l-042 dhe rregulloreve në fuqi mbi prokurimin publik dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike. Zyra e prokurimit në afatin ligjor ka bërë planifikimin e Prokurimit Publik, i cili është miratuar në kuvendin komunal dhe është dorëzuar në APP.

Në vitin 2021 kemi iniciuar 89 procedura të prokurimit, ku vlera e tërësishme e buxhetit është 2.343.825.00 euro. Siç parashihet me nenin 9 të Ligjit të Prokurimit Publik është bërë planifikimi i prokurimit dhe i njëjti në bazë të kërkesave të drejtorive është miratuar edhe nga kuvendit i komunës, që në bazë të llojit janë:

1. Furnizime 28 procedura apo 32%;
2. Shërbime 23 procedura apo 26%;
3. Punë 35 procedura apo 40%;
4. Konkurse projektimi 1 procedurë apo 2%.

Totali i planifikuar janë 87 procedura apo në vlerën e buxhetit 4.764.660.00 euro.

- Procedimi:
  1. Janë iniciuar 140 procedura prokurimi apo 162%.
- Llojet e prokurimit janë:
  1. Furnizime 32 apo 21%;
  2. Shërbime 33 apo 24%;
  3. Punë 70 apo 51%;
  4. Ankande 5 apo 4%.
- Procedurat sipas vlerave të kontratave:
  1. Vlerë e madhe 5;
  2. Vlerë e mesme 80;
  3. Vlerë e vogël 30;
  4. Vlerë minimale 13.
- Procedurat e prokurimit:
  1. Procedurë e hapur; 86;

2. E negociuar ( punë shtesë) 12;
3. Kuotimi 25;
4. Vlerë minimale 13;
5. Procedura të shitjes 3.

### Zyra ligjore

Si në periudhat e viteve të mëparshme edhe gjatë vitit 2021 zyra ligjore dhe e përfaqësimit, në bazë të ligjit dhe rregullatives ligjore ka kryer dhe përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë që i ka pasur në kompetencën e saj.

Në kuadër të kompetencës së saj zyra ka kryer përfaqësimin e komunës në të gjitha shkallët e gjyqësorit në nivel vendi, duke përfshi tërë aktivitetin e përgjegjësisë së përfaqësimit, gjegjësisht avokaturës shtetërore.

Përveç përgjegjësisë së lartcekur, zyra ligjore ishte edhe pjesë e të gjitha debateve dhe takimeve tjera me publikun që janë mbajtur gjatë periudhës raportuese. Zyra ligjore, po ashtu, ishte pjesë e të gjitha seancave të kuvendit të komunës.

Në vijim të këtij raporti paraqitet tabelari i lëndëve gjyqësore të aktualizuara gjatë vitit 2021 si dhe më tutje edhe tabelari i seancave të mbajtura gjyqësore gjatë periudhës raportuese.

### **Tabelari dhe komparacioni i lëndëve gjyqësore të aktualizuara-paraqitura gjatë vitit 2021, në raport më të njëjtën periudhë të vitit 2020.**

---

**i.**

Gjithsej numri i lëndëve  
në tërë vitin 2021  
(janar-dhjetor)

**ii.**

Vërejtje

---

**29** Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë në gjykatat kompetente.

---

Gjithsej numri i lëndëve  
në vitin 2020  
(janar-dhjetor)

Vërejtje

---

**42** Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë në gjykatat kompetente.



Siç shihet nga krahasimet e periudhave raportuese, në vitin 2021 ishin aktualizuar gjithsejtë 29 lëndë të reja gjyqësore, përderisa numri i lëndëve në vitin 2020 ishte gjithsej 42 lëndë. Nga kjo pasqyrë shihet se numri i lëndëve në vitin 2021 ishte më i vogël për 13 lëndë. Po ashtu, më poshtë mund të shihni numrin e seancave të mbajtura nga gjykata.

Të gjitha këto lëndë kanë pasur kërkesëpaditë e natyrave të ndryshme juridike, veçanërisht kërkesëpadi civile-kontestimore si: vërtetim pronësie, pastaj nga lëmia e marrëdhënies së punës, e drejta e shfrytëzimit të tokës komunale-trojet ndërtimore, borxhet përkatëse financiare të komunës ndaj subjekteve të tjera dhe e kundërta si dhe lëndë të tjera.

Sa i përket shqyrtimeve gjyqësore dhe seancave gjyqësore të mbajtura te gjykatat e vendit gjatë tërë vitit 2021 janë mbajtur gjithsej 171 seanca të shqyrtimeve gjyqësore, duke përfshirë ato përgatitore dhe ato të rregullta. Në krahasim me vitin paraprak 2020, që ishin mbajtur 135 seanca gjyqësore vërehet diferenca që në vitin 2021 janë mbajtur 36 seanca më shumë.

**Tabelari dhe komparacioni i seancave gjyqësore të mbajtura gjatë tërë vitit 2021, në raport më të njëjtën periudhë të vitit 2020**

---

i.

ii.

---

Gjithsej numri i seancave në vitin 2021  
(janar-dhjetor)  
**171**

Vërejtje:

---

Gjithsej numri i seancave  
në vitin 2020  
(janar-dhjetor)  
**131**

Vërejtje

---

Zyra ligjore dhe përfaqësimit si në të gjitha vitet e mëparshme ka përfaqësuar komunën edhe në nivelet ministrore sa i përket përfaqësimit të lëndëve konkrete administrative, ku ka lindur nevoja, por edhe të këshillimeve përkatëse për të gjitha çështjet juridike. Në këtë drejtim zyra ka marr pjesë në disa takime on-line si dhe disa me prezencë fizike të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës(AKK), qq kanq të bëjnë më zyrtarq ligjor. Kjo është më rëndësi të ceket se në ato takime bëhen përpjekjet e unifikimit të veprimeve dhe të gjitha procedurave ligjore në nivel vendi.



Zyra ligjore, po ashtu, në kuadër të kompetencave të veta gjatë tërë vitit 2021 ka lëshuar edhe akte të tjera juridike, si për zyrën e kryetarit të komunës dhe për terë ekzekutivin komunal, si: vendime, urdhëresa, pëlqime, ka hartuar marrëveshje të ndryshme, autorizime, shkresa dhe akte të tjera të cilat radhitën si në vijim:

Sipas kërkesave për subvencionim me rastin e lindjes së fëmijëve, gjatë vitit 2021 janë aprovuar 260 vendime nga të cilat 96 vendime për lindjen e parë, 66 vendime për lindjen e dytë, 57 vendime për lindjen e tretë, 25 vendime për lindjen e katërt, 8 vendime për lindjen e pestë, 5 vendime për lindjen e gjashtë si dhe nga 1 vendim për lindjen e shtatë dhe tetë. 4 kërkesa janë refuzuar si të pabazuara. Për kompensimin e shpenzimeve të varrimit gjatë vitit 2021 janë aprovuar 254 kërkesa, ndërsa 1 është refuzuar si e pabazuar, ku për këto janë lëshuar 255 vendime. Për ndihmë shëndetësore momentale - subvencionime sipas kërkesave janë aprovuar 103 vendime si dhe janë hartuar 68 vendime të natyrave procedurale të ndryshme. Në total gjatë vitit 2021 hartuar 686 vendime, 15 kërkesa, 10 autorizime, 6 marrëveshje, 11 pëlqime, 12 lista, 7 përgjigje, 6 njoftime, 2 padi, 1 ankesë, 6 mendime juridike si dhe disa shkresa përcjellëse.

Për të gjitha kërkesat dhe aktet tjera zyrtare të cilat janë futur në shërbimin e intranetit te zyra e kryetarit, zyra ligjore dhe përfaqësimit ka menaxhuar me statusin e lëndëve lidhur me vendosjen e tyre nga organet kompetente.

Në kuadër të aktiviteteve tjera ligjore zyra po ashtu ka ofruar të gjitha këshillat e nevojshme dhe të kërkuara nga strukturat tjera të administratës komunale.

Për përfundim mund të konkludojmë se zyra ligjore dhe e përfaqësimit gjatë vitit 2021 ka pasur një aktivitet më të shtuar në përmbushjen e kompetencave ligjore të saja në respektim të ligjit.

### **Shërbimi për punë të kuvendit**

Shërbimi për punë të kuvendit për vitit 2021 ka përgatitur materialin për 9 seanca të rregullta, 2 seanca të jashtëzakonshme, 1 seancë solemne. Debate me publikun janë mbajtur 2. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 janë miratuar 52 vendime, nga aktet e miratuara në kuvend. Pas vlerësimit të ligjshmërisë 6 janë kthyer në rishqyrtim lidhur nga Ministria përgjegjëse.

Janë miratuar vendime dhe rregullore të kuvendit të komunës së Klinës. Janë shqyrtuar dhe miratuar raporte financiare. Të gjitha vendimet dhe rregulloret janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë në afat të caktuar në MAPL.

Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur 8 takime.

Komiteti për Komunitete 7 takime.

Komiteti për Bujqësi 3 takime.

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi (KKSB) 2 takime.

Takime me qytetarët – kryetari ka mbajtur 2 takime.



### Zyra pritëse - Arkivi

1. Drejtoria e Administratës; gjithsej lëndë të regjistruara,	1.176
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; gjithsej lëndë të regjistruara 59,	
3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport; gjithsej lëndë të regjistruara 292,	
4. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi; gjithsej lëndë të regjistruara 510,	
5 Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim; gjithsej taksa të inkasuar 491,	
6.Drejtoria e Arsimit; gjithsej lëndë të regjistruara	1.500
7.Drejtoria e Bujqësisë; gjithsej lëndë të regjistruara	1.719
8. Drejtoria e shërbimeve publike; gjithsej lëndë të regjistruara	533
9.Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; gjithsej lëndë të regjistruara 941	
10.Drejtoria e Inspektoratit; gjithsej lëndë të regjistruara	1.026,
11.Kuvendi i komunës; gjithsej lëndë të regjistruara	216
12. Presidenca; gjithsej lëndë të regjistruara	1.210
13. Zyra e prokurimit; gjithsej lëndë të regjistruara	309
14. Zyra për kthim dhe komunitete; gjithsej lëndë të regjistruara	64

Vlera totale e taksave të inkasuara për vitin 2021 është 1.913.01 euro.

Ky sektor përveç kësaj gjatë kësaj periudhe ka regjistruar edhe vërtetuar përshkrime dhe dorëshkrime dhe kërkesa të palëve. Ky sektor gjatë kësaj periudhe ka lëshuar edhe vërtetime, deklarata, me kërkesë të palëve. Në librin e postës janë regjistruar dërgesa, të cilat janë dorëzuar PTK-së në Klinë. Në regjistrin e postës në vend janë regjistruar shkresa të dala nga komuna e Klinës, të cilat janë shpërndarë në teren, në gazeta zyrtare.

### **Zyra e informimit**

Zyra për informim dhe marrëdhënie me publikun gjatë vitit 2021 i ka mbuluar të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në komunë. Në vazhdimësi kemi lëshuar komunikata për media për të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në komunën e Klinës, në ueb faqen e komunës si dhe në llogarinë zyrtare në facebook. Përmes ueb faqes, qytetarët janë informuar për çdo ngjarje në kohë. Po ashtu, përmes publikimeve të vazhdueshme dhe në kohë në ueb faqe si dhe në llogarinë zyrtare në facebook të komunës së Klinës, kemi vërejtur se interesimi i qytetarëve për t'i përcjellë zhvillimet komunale secilin vit është duke u rritur dhe kemi kërkesa që na drejtohen po nga mesazhet në facebookut, të cilat përcillen te sektorët përkatës.

Edhe vitin 2021 kemi vazhduar me një pjesë të takimeve on-line, për shkak të gjendjes aktuale me pandemi COVID-19. Të gjitha takime janë zhvilluar sipas planit të punës. Në qasjen e dokumenteve publike janë gjithsej 23 kërkesa.



### *Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore*

Zyra për barazi gjinore gjatë kësaj periudhe kohore ka mbajtur 4 takime. Takimi për punë dhe performancë në komunë i mbajtur me datë 20.08.2021. Takimi tjetër i organizuar në kuadër të projektit të USAID-it, me temën “ndërmjetësimi dhe përparësitë e shërbimit të ndërmjetësimit” i mbajtur përmes platformës *zoom online*, ku qëllimi i këtij takimi ka qenë shpalosja për informimin mbi ndërmjetësimin si mekanizëm ligjor.

Një takim tjetër të organizuar nga OJQ “Advancing Together” në bashkëpunim me misionin e UNCHR-së në Kosovë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim me temë “personat e zhvendosur dhe të kthyerit - qasja në të drejtat e njeriut” përmes platformës *zoom online*, ku qëllimi i këtij takimi ka qenë shpalosja e problemeve të të zhvendosurve dhe të të kthyerve, veçanërisht të minoritetit rom, ashkali dhe egjiptian, ku problemet janë të shumta, sidomos në banim, shkollim, shëndetësi dhe mbrojtja e të drejtave të tyre, sidomos përfshirja e grave të kthyerat dhe të zhvendosura në jetën politike, socio-ekonomike dhe kulturore dhe çështje të tjera.

Po ashtu, më datën 28.10.2021 është mbajtur edhe një takim pune lidhur me antigjipizmin me përfaqësuesin e Klinës si moderator për rom, ashkali dhe egjiptian, z. Senad Ramaj, i cili ka për qëllim të adresojë problemin e racizmit ndaj romeve, ashkalive dhe egjiptianëve në Klinë.

#### *Zyra për integritet evropiane*

Aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2021:

- Më 21.01.2021 kam përcjellur në MAPL raportin për përmbushjen e obligimeve të komunës së Klinës nga agjenda evropiane e vendit për periudhën janar – dhjetor 2020.

- Me MAPL-në në vazhdimësi komunikojmë për informime dhe koordinime të ndërsjella, sipas kërkesës i janë përcjellur disa nga planet dhe strategjitë komunale. Gjithashtu kam marrë pjesë në takimet on-line të organizuara për ZKIE-të.

- Më 13.07.2021 kam dërguar në MAPL raportin mbi përmbushjen e obligimeve të komunës së Klinës ndaj agjendës evropiane, për periudhën janar-qershor 2021.

rekomandimet nga raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane, për komunën e Klinës janë:

1. Të hartohet strategjia kundër dhunës në familje;
2. Të hartohet plani lokal për integritet;
3. Të hartohet plani tre-vjeçar për strehim social;
4. Të hartohet plani për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
5. Të hartohet plani programi për bujqësi dhe zhvillim rural;
6. Të hartohet plani komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar;
7. Të miratohet planin për menaxhimin e tokave rurale;
8. Të hartohet plani i veprimit për cilësinë e ajrit;
9. Të themelohet dhe të funksionalizohet ekipi vepruese për siguri (evs);
10. Të themelohen këshillat në fshatra;



11. Të caktohet zyrtari për mbrojtjen nga diskriminimi;
12. Të caktohet zyrtari që raporton për planin për integritet;
13. Të caktohet zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

### ***Zyra për teknologji informative***

Gjatë kësaj periudhe janë kryer punët si në vijim:

Është përkrahur stafi i administratës komunale të komunës së Klinë në aspektin e teknologjisë informative, duke përfshirë intervenime në pajisje e TI-së, si kompjuter, printer, monitor dhe pajisje tjera periferike për të mbarvajtur punët në normalitet, të jenë sa më efikas për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Po ashtu, gjatë pandemisë COVID-19 shërbimi i TI-së i ka kryer punët pa ndërprerje nga distanca (remote).

Shërbimi i TI-së ka bërë instalimin e kompjuterëve të rinj, të cilët janë blerë nga administrata gjatë vitit 2021, duke instaluar softuer të nevojshëm me konfigurimet e nevojshme konform udhëzimeve administrative dhe ligjeve në fuqi si dhe ku ka qenë e nevojshëm i janë bartur shërbimet nga pajisjet e vjetra në pajisjet e reja. Ne këtë pikë, konsideroj që komuna e Klinës e ka të nevojshëm që të rrisë kapacitetet e pajisjeve të TI-së, sidomos për kompjuter ku në disa shërbime ka kompjuterë që janë aktiv duke punuar rreth 10 vite dhe me rekomandimet nga Microsoft për të kaluar në sistemet e fundit operative pasi që tani edhe windows 7 nuk ka më *support*, është e pamundur që të realizohet një gjë e tillë pa blerjen e kompjuterëve të rinj dhe kjo është e nevojshme që rreth 15% e kompjuterëve të zëvendësohen me të rinj. Në fillim të kësaj periudhe janë gjëndëruar raportet nga sistemi i intranetit për lëndët të cilat janë gjëndëruar nga sistemi si dhe nga ky shërbim është bërë edhe raportimi për MAPL-në në tre indikatorët e parë të vlerësimit të performancës. Janë bërë të gjitha përditësimet e sistemeve të brendshme që ofrojnë shërbime për qytetarët dhe për stafin komunal në përputhje me udhëzimet administrative nga Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit si dhe rekomandimet e prodhuesve. E-kiosku është mirëmbajtur nga zyra e TI-së për të qenë funksional 24/7, i cili edhe gjatë këtij viti ka gjetur përdorim të mirë nga qytetarët.

Po ashtu, gjatë këtij viti është bërë edhe përkrahja në aspektin teknik për zyrat e gjendjes civile në teren, ku janë bërë intervenime në distanca si dhe në bazë të nevojave është bërë edhe intervenim lokal, që të jenë funksionale të gjitha zyrat si në aspektin e lidhjeve *VPN*, po ashtu edhe në funksionalitetin e pajisjeve si kompjuter, monitor, printer, fotokopjues dhe skaner.

Është instaluar sistemi i menaxhimit të radhës në ZGJC-Klinë, e cila zyrë ka kaluar në hollin e ndërtesës së komunës dhe si rrjedhojë ka pasur ndikim pozitiv nga ana e qytetarëve të cilët shërbehen duke iu përmbajtur radhës dhe nuk ka pakënaqësi gjatë ofrimit të shërbimit në gjendjen civile. Gjatë kësaj periudhe është bërë koordinimi i punëve në teren, në bashkëpunim me kontraktin për mirëmbajtje të kamerave të qytetit, segmenti nga komuna në drejtim të sheshit "Mujë Krasniqi" dhe duke vazhduar në drejtimin e rrugës për në Skenderaj dhe segmenti tjetër në drejtim të rrugës për Istog deri te sheshi "Nënë Tereza" është vendosur e gjithë infrastruktura në galeri dhe janë eliminuar kabllo ajrore në shtylla.

Gjatë këtij viti është përkrahur zyra e informimit për publikimin e materialeve në ueb faqe, kur e kanë pasur të nevojshme ndihmën e shërbimit të TI-së. Për vitin 2021 janë bërë të gjitha përditësimet e sistemeve të brendshme me rekomandimet e *Microsoft*-it dhe *ASHI*-së.



### **Zyra e pranimi të mallit**

Nga ky sektor është kryer puna e pranimi të mallit, të gjitha hyrjet dhe daljet e materialeve shpenzuese dhe kompjuterëve, printerëve, fotokopjeve e materiale tjetër shpenzuese. Gjithashtu janë kryer edhe raporte të pagesave në *free-balance*.

### **Zyra e personelit**

Gjatë vitit 2021 kjo zyrë ka zhvilluar gjithsej:

- konkurse të rregullta me ligjin e punës 5
- konkurse të brendshme për shërbyes civil 3
- Konkurse të jashtme për shërbyes civil 6
- Vendime për pushime vjetore, janë lëshuar 131
- Përmes zyrës së personelit, ankesa janë zhvilluar 2
- Përgjigjeje në ankesa KPMK-së 2
- Raporte për MAPL-MAP, gjatë vitit 2021 sipas kërkesave
- Janë miratuar gjithsej 1.420 lëndë
- Digjitalizimi i dosjeve 100
- Vendime për ndërprerje të punës (pensionim) 11
- Trajnime të zhvilluara 12
- Vendosja në HRMS të gjitha konkurset nga drejtoria e shëndetësisë dhe arsimit

### **Spektori teknik – Logjistika**

Nga ky sektor është bërë sigurimi i objektit të komunës, organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e ngrohjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajtja e veturave zyrtare, përcjellja e shkresave për organe dhe palët dhe pune tjera sipas nevojës.

### **Njësia e auditimit të brendshëm**

Për periudhën raportuese për vitin 2021, sipas planit të punës të NJAB kanë qenë të parapara 4 auditime, të cilat janë zhvilluar në disa drejtori në kuadër të ekzekutivit të komunës. Këto auditime janë kryer të gjitha në pajtueshmëri me planin e aprovuar vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm për vitin 2021. Të gjitha këto në bazë të nevojave reale dhe gjendjes së analizuar nga auditorët. Gjatë vitit 2020 nga njësia e auditimit të brendshëm janë realizuar auditimet dhe punët si ne vijim:

1. Të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe procedurat e lëshimit të lejeve të ndërtimit për vitin 2020;
2. Të hyrat dhe shpenzimet në arsim dhe shëndetësi për vitin 2021;
3. Subvencionet në Drejtorinë e Bujqësisë; janar 2020 - gusht 2021;
4. Shpenzimet për investime kapitale 2021;





Nga auditimet e përfunduara për vitin 2021 gjendja statistikore e objektivave, të gjeturave dhe rekomandimeve është kjo:

- Janë përcaktuar 13 objektiva për auditimet e përfunduara;
- Të gjeturat nga auditimet e përfunduara për vitin 2021 janë 34 dhe të cilat janë vlerësuar si rrezik për funksionim në sektorët e audituar;
- Janë dhënë 24 rekomandime, me qëllim të përmirësimit të të gjeturave.

Krahas auditimeve të përfunduara nga NJAB janë kryer edhe punë tjera si:

- Përgatitja e planit strategjik për njësinë e auditimit të brendshëm për periudhën trevjeçare 2022- 2024;
- Përgatitja e planit vjetor për njësinë e auditimit të brendshëm për vitin 2022;
- Përgatitja e 4 planeve të auditimit të punës për secilin auditim të veçantë, me formularët e duhur përcjellës;
- Përgatitja e raporteve 6 mujore dhe raportit vjetor të punës për NJQHAB dhe kryetarin e komunës;
- Përgatitja e 4 planeve të veprimit të menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve;
- Përgatitja e orareve përcjellës të rekomandimeve për monitorim nga auditimi i brendshëm për të gjitha auditimet e përfunduara për vitin 2021;
- Mbajta e takimeve të rregullta me komitetin e auditimit;
- Bashkëpunimi me auditorët e jashtëm rreth punës së NAJB dhe ofrimi i shënimeve të cilat janë kërkuar nga ana e tyre;
- Përcjellja e trajnimeve që kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm, që është obligative për të mundur ta ushtrosh punën e auditorit dhe për vazhdimin e licencimit;
- Konsultime me menaxhmentin lidhur me auditimet;
- Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për menaxhmentin dhe sektorët e veçanta;
- Konsultime profesionale me NJQHAB.
- Janë kryer edhe konsultime duke dhënë rekomandime tjera me ekzekutivin dhe punëtorët e administratës sipas nevojës;
- Pjesëmarrja në komisione të ndryshme.

### ***Zyra për komunitete dhe kthim***

Zyra ka kryer punët e saj të përditshme në terren si dhe përcjelljen e gjendjes dhe nevoja të të kthyerve si dhe punët brenda zyrës.



### **3. DREJTORIA PËR FINANCA EKONOMI DHE ZHVILLIM**

#### **Përmbledhje**

Në fillim të vitit 2021 gjatë hartimit të planit të punës së Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim kishim përcaktuar disa objektiva për t'i realizuar, prej tyre ndër me të rëndësishmet ishin:

1. Ngritja dhe përmirësimi i inkasimit të të hyrave vetanake;
2. Menaxhimi efikas dhe transparent i buxhetit të komunës së Klinës për vitin 2021;
3. Përgatitja dhe hartimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve buxhetore 2022-2024 dhe propozim i buxhetit për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitin 2023 dhe 2024;
4. Marrja e masave për përkrahjen dhe mbështetjen e bizneseve lokale të komunës së Klinës.

Po mbi bazën e këtyre katër objektivave, për secilin objektiv ne kemi përcaktuar një numër nënobjektivash si dhe një plan operativ të afatizuar dhe me veprime konkrete për realizimin e planit të punës për vitin 2021 dhe tani kur po bëjmë bilancin e të arriturave, përkatësisht raportin e punës së drejtorisë për vitin 2021 mund të konstatojmë se kemi arritur të realizojmë një pjesë të këtyre pritjeve të cilat i kemi parashtruar me planin e punës për vitin 2021.

1. Nëse fillojmë me objektivin e parë, përkatësisht inkasimit të të hyrave vetanake të komunës si një nga burimet e rëndësishme të buxhetit komunal, gjatë vitit 2021 ka vazhduar trendi i mirë i inkasimit të të hyrave vetanake sikurse edhe në vitin 2020, por edhe pse kemi pasur vështirësi më pandeminë COVID-19, kemi arritur që të hyrat komunale t'i realizojmë dhe t'i tejkalojmë planifikimin e paraparë. Kjo falë angazhimit permanent të të gjithë faktorëve relevant të komunës. Në këtë mënyrë po pasqyrojmë periudhat vjetore të realizimit të të hyrave sipas viteve siç vijon:

#### **Të hyrat vetanake të komunës së Klinës në vitin 2018:**

- Me donacione dhe participime 1.140.944,26 euro;
- Pa donacione dhe participime 1.011.520,40 euro.

#### **Të hyrat vetanake të komunës së Klinës në vitin 2019:**

- Me donacione dhe participime 1.163.859,33 euro;
- Pa donacione dhe participime 1.144.244,10 euro.

#### **Të hyrat vetanake të komunës së Klinës në vitin 2020:**

- Me donacione dhe participime 986,325.58 euro;
- Pa donacione dhe participime 975,015.58 euro.

#### **Të hyrat vetanake të komunës së Klinës në vitin 2021:**

- Me donacione, participime dhe gjoba 1,675,600,05;
- Pa donacione, participime dhe gjoba 1.365.338,25.

Nisur nga treguesit e mësipërme, nëse krahasojmë të hyrat e realizuara duke përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat e trafikut dhe gjobat e gjykatave në krahasim me planifikimin e të hyrave 1,675,600.05/830,437.00, del se të hyrat janë realizuar 201 % ose 101% mbi planin. Ndërsa nëse krahasojmë vetëm të hyrat direkte që mbledhen nga komuna në raport me të hyrat e planifikuara 1,365,338.25/830,437.00, atëherë del se plani është tejkalluar për 64.41% që po



ashtu është një rekord i ri sa i përket realizimit të të hyrave vetanake, pas atij të vitit 2019. Trendi pozitiv i inkasimit të të hyrave edhe përkundër prezencës së pandemisë COVID-19 dhe vitit zgjedhor ka vazhduar të të hyrat nga tatimi në pronë, ku gjatë vitit 2021 është arritur edhe një rekord i ri që nga fillimi i aplikimit të tatimit në pronë duke inkasuar mjete në vlerë prej 488,480.94 apo 185,218.10 më shumë se në vitin paraprak dhe 116,054.22 më shumë se në vitin 2019.

2. Sa i përket objektivit të dytë që ka të bëjë me menaxhimin e buxhetit rregullisht është monitoruar dhe analizuar ekzekutimi i buxhetit nga programet buxhetore komunale (drejtoritë komunale). Në vazhdimësi janë propozuar masa përkatëse në drejtim të përmirësimit të menaxhimit dhe transparencës në shpenzimin e buxhetit të komunës. Drejtoritë komunale janë njoftuar rregullisht me rrjedhat dhe progresin e zbatimit të buxhetit, me vlerat e shpenzuara të buxhetit dhe vlerën e mjeteve në dispozicion. Janë përgatitur dhe realizuar disa kërkesa për rialokim dhe transfer të mjeteve ndërmjet dhe brenda programeve buxhetore komunale, me qëllim të ndarjes së mjeteve buxhetore për përballimin e pasojave të pandemisë, por edhe për shfrytëzimin sa më racional të parave publike si rezultat i procedurave të tenderimit për projektet kapitale.

3. Një objektiv tjetër gjatë vitit 2021 që zhvillohet në formë të një procesi të rregullt buxhetor, përkatësisht një cikli vjetor buxhetor ka qenë përgatitja dhe hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024, që ka filluar në muajin prill dhe është finalizuar në muajin qershor 2021 me aprovim nga ana e kuvendit komunal. Po ashtu, përgatitja dhe dorëzimi në kuvendin komunal i draft buxhetit për vitin 2022 si dhe vlerësimet e hershme për vitin 2023 dhe 2024 në fillim të shtatorit dhe që është shqyrtuar dhe aprovuar në fund të muajit shtator 2021. Prosesi buxhetor është zhvilluar me muaj të tërë, përkundër gjendjes së krijuar nga pandemia si dhe janë mbajtur një numër debatesh publike me qytetarë. Kemi mbajtur 12 dëgjime më publikun që kanë dhënë rezultate shumë pozitive që janë marr për bazë në hartimin e buxhetit për vitin 2022. Sa i përket përgatitjes dhe raportimeve financiare, si drejtori kemi përgatitur raporte të rregullta financiare tremujore dhe kemi raportuar në mënyrë të rregullt në kuvendin komunal. Po ashtu kemi në përgatitje të raportit përfundimtar vjetor financiar për vitin 2021.

4. Lidhur me objektivin e katërt gjatë vitit 2021, është zhvilluar edhe një aktivitet në drejtim të informimit të bizneseve lidhur me mundësitë e ofruara për financim të aktiviteteve biznesore nga grantet, donacionet dhe formave të tjera të përkrahjes nga ministrinë përkatëse të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të ndryshme joqeveritare që kanë programe dhe ndajnë mjete në përkrahje të bizneseve. Gjithashtu në vitin 2021 janë ndihmuar disa biznese që janë dëmtuar nga vërshimet e fundvitit 2020 dhe fillimi i vitit 2021.

Ndër aktivitetet dhe sukseset e arritura gjatë vitit 2021 mund të përmendim edhe këto:

Kemi vazhduar me pagesën e pagave përcjellëse të mësimdhënësve të pensionuar si obligim ligjor në bazë të kontratës kolektive të Qeverisë së Kosovës dhe SBASHK-ut për vitet paraprake dhe për periudhën vijuese. Kemi filluar me pagesën e shujtave për punëtorët arsimor dhe procesi do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2022. Një numër të rekomandimeve të raportit të auditimit të jashtëm kemi arritur t'i zbatojmë plotësisht dhe për disa të tjera kemi në proces të zbatimit të tyre.

Aktivitetet administrative të punëve të përditshme të realizuara në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:

Sa i përket aspektit të angazhimeve të stafit të drejtorisë në realizimin e punëve administrative dhe detyrave të përditshme të punës, ato janë kryer në harmoni me ligjin për vetëqeverisje lokale, me statutin komunal, ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi,



ligjin mbi financat lokale, ligjin e tatimit në pronën e paluajtshme dhe udhëzimeve administrative nga Qeveria Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që dalin nga to dhe bazuar në planin e punës së aprovuar nga kuvendi komunal për vitin 2020, siç vijon:

- Janë përgatitur dhe janë lëshuar 1350 aktvendime për biznese që operojnë në komunën e Klinës për ushtrim të veprimtarive afariste, të cilat janë bazuar në rregulloren komunale mbi ngarkesat, tarifat, gjobat dhe taksat komunale;
- Këto aktvendime janë lëshuar në kohën e përcaktuar sipas këtyre akteve ligjore dhe nënligjore, duke i dërguar përmes postës të çdo obliguesit të këtyre taksave;
- Janë vendosur në procedura ligjore 5 ankesa të ushtruara nga obliguesit e këtyre taksave, duke i informuar ushtruesit e këtyre ankesave për epilogun e vendosjes së tyre;
- Janë lëshuar 32 kontrata për obliguesit e taksave komunale që nuk i kanë përmbushur obligimet e që kanë dëshiruar që ato obligime t'i kryejnë me marrëveshje të dakurduar mes obliguesit dhe drejtorisë përkatëse;
- Në këtë vit drejtorja ka lëshuar vërejtje me shkrim për bizneset që nuk i kanë përmbushur obligimet e taksave;
- Në këtë vit vlen të përmendet dhe aksioni i organizuar nga drejtori i drejtorisë për verifikimin e të gjitha bizneseve që operojnë pa u regjistruar si biznese, që është në kundërshtim me ligjet aplikative dhe se ai regjistër i konstatuar nga zyrtarët e autorizuar nga drejtori i është dorëzuar drejtorisë së inspektoratit dhe organeve tjera kompetente, me qëllim të eliminimit të atyre bizneseve që operojnë ilegalisht në komunën tonë;
- Janë përgatitur 50 kërkesa për përmbardim, të cilat nuk janë dërguar të përmbarduesit për ekzekutim të obligimeve të pakryera;
- Në këtë vit është marrur iniciative nga kjo drejtori që të aprovojë rregullat për pasurinë jofinanciare të cilat rregulla janë aprovuar nga bordi i drejtorëve të komunës së Klinës, të cilat kanë qenë edhe si rekomandim i auditorëve të jashtëm;
- Në vitin 2021 janë regjistruar 95 biznese të reja;
- Shuarje të bizneseve kanë qenë 24 biznese;
- Ndryshime në biznese - 42;
- Marrja e certifikatave të reja të bizneseve - 160 certifikata;
- Lëshimi i aktvendimeve për zgjatje të orarit - 8 aktvendime,
- Leje për auto-taksi - 76 leje,
- Leje për itinerar të autobusëve - 2 leje,

Raporte periodike tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore.

- Janë kryer të gjitha punët profesionale të planifikuara, si regjistrimi dhe raportimi i të gjitha të hyrave në organet lokale dhe ato qendrore, zotimi i të gjitha mjeteve buxhetore, pagesa e të gjitha taksave komunale, lëshimi i vërtetimeve për kryerje të obligimeve për qytetaret, certifikimi dhe shpenzimi i pagesave në zyrën e thesarit, regjistrimi i pasurisë komunale në *freebalance*, përgatitja e formularëve për ndryshim të pagave sipas kërkesave, tërheqja dhe menaxhimi i *pt-cash-it* si dhe shumë punë tjera profesionale sipas planit të paraparë vjetor.



## *Zyra e tatimit në pronë*

Zyra komunale e tatimit në pronë për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021 ka përmbushur relativisht mirë obligimet dhe detyrat që dalin nga Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/l-005 dhe rregullores komunale të tatimin në pronë. Janë përgatitur dhe rifreskuar të dhënat për printimin e rreth dhjetëmijë faturave të tatimpaguesve. I gjithë ky material i shtypur dhe i vendosur në zarfe, i`u është shpërndarë tatimpaguesve përmes postës së Kosovës në bazë të kontratës. Vlera e tatimit të faturuar për vitin 2021 është gjithsej 500.495 €, prej tyre 393.658 € për objekte, shtëpi, lokale afariste, objekte tjera dhe 106.837€ për parcela. Gjatë kësaj periudhe të vitit fiskal janar-dhjetor 2021 nga ZKTP janë inkasuar gjithsej 488.481€, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 janë inkasuar më shumë 185 000 € ose shprehur me numra relativ 61 % me shumë. Inkasimi për objekte është 454 287 €, ndërsa inkasimi për parcela 34 194 €. Të dhënat për këtë ndarje është e përafërt sepse nuk i kemi disa të dhëna të përpunuara nga sistemi i programit të tatimit në pronë, disa pagesa të pa regjistruara gjatë vitit 2021 si dhe mosregjistrimi i pagesave për muajin dhjetor 2021. Jemi bazuar në të hyrat janar-nëntor 2021 dhe këtë përqindje- strukturë të të hyrave e kemi zbatuar edhe për të hyrat tjera të paregjistruara. Inkasimi i obligimeve për vitin 2021 kap vlerën prej 196 589 euro. Gjithsej prej tyre inkasimi për objekte 175 829 € dhe inkasimi për parcela 20 760 euro. Pjesa tjetër e inkasimit i përket obligimeve të viteve paraprake, afërsisht 291 892 euro, por edhe këtu i kemi të dhëna të përafërta sepse të hyrat që nuk janë regjistruara në sistemin e programit të tatimit në pronë i kemi kalkuluar si të hyra para vitit 2021. Pra, sipas të dhënave, zyra komunale e tatimit në pronë ka siguruar më shumë se 35.5% të të hyrave direkte në buxhetin e komunës së Klinës. Në vitin 2021 kjo zyrë ka kryer edhe shumë punë tjera si lëshimi i certifikatave, kartelave financiare, njoftime për tatimpagues jo të rregullt, faturave të rregullta për qytetarë, pra për persona fizik dhe persona juridik. Tatimpaguesve jo të rregullt ua kemi dërguar 144 letërkujtesa, së bashku me shumën e obligimeve dhe mundësive ligjore për riprogramim të obligimeve si dhe masat tjera nëse nuk paguhet detyrimet e tatimit në pronë, si kamata, dënimi etj. Do të fillojnë edhe masat për mbledhje të detyrueshme. Kjo përfshinë pezullimin e shërbimeve komunale si dhe propozimin për mbledhjen e detyruar të detyrimeve të papaguara përmes përmbaruesve. Pas këtyre letërkujtesave është vërejtur një interesim i qytetareve për pagim të detyrimeve apo lidhjes së kontratave për riprogramim të tyre. Janë shqyrtuar katërdhjetë ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë si dhe ankesa ndaj certifikatës së vlerës së vlerësuar dhe mbi njëqind kërkesa të ndryshme. Janë kryer 375 regjistrime te reja te pronave (objekteve) në teren. Sipas nenit 15 pika 2 te ligjit nr.06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, komuna duhet inspektuar 20% të pronave (Klina ka mbi dhjetëmijë tatimpagues, ndersa ka inspektuar 3.667 prona). Pra jemi në limitet e kërkuara sipas ligjit. Modifikime tjera; regjistrim të numrit personal, përmirësime emri, mbiemri, ndryshime të emrave të tatimpaguesve etj. Gjithsej 3 738 lëndë.

Më poshtë janë shënimet e inkasimit për periudhën janar –dhjetor sipas muajve për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Viti

Muaji: janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor. Gjithsej:



	2011	9	11	17	20	15	22	33	26	12	9	
11 25	210											
2012 212	12	8	14	14	23	18	23	25	17	10	11	37
2013 235	19	16	23	17	17	21	23	31	11	14	12	31
2014 270	19	30	21	22	20	20	25	28	16	13	14	40
2015 266	25	15	20	22	16	34	26	30	15	13	11	39
2016 298	19	14	18	28	22	37	23	61	22	11	12	31
2017 270	14	12	23	29	22	35	26	45	12	9	10	33
2018 327	20	13	28	22	24	28	34	45	12	14	32	55
2019 372	29	17	19	20	30	43	41	50	27	23	29	44
2020 303	33	29	21	2	12	28	27	24	23	39	18	47
2021 488	29	42	44	44	35	51	42	67	34	30	26	44

Vërejtje: Të dhënat janë të rrumbullakosura dhe janë të shprehura në mijë euro.

#### **4. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjithë fushëveprimtarinë e vet e ushtron në bazë të dispozitave ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, planeve dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve të kuvendit të komunës.

Në kuadër të drejtorisë veprojnë:

- Shërbimi i ndërtimit dhe banimit;
- Zyra për mbrojtje të mjedisit;
- Planifikimi urban;
- Zyra për projekte.

Në kuadër të kësaj drejtorie ushtrohen këto veprimtari:

- Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit;
- Legalizimi;
- Punët dhe aktivitetet rreth urbanizmit –planifikimit;
- Leje mjedisore komunale;
- Mirëmbajtja e sistemit të adresave;
- Hartim të paramasave dhe parallogarive, përgatitje të projektpropozimeve, raporte teknike, procesverbale, shkresa etj;
- Menaxhim dhe mbikëqyrje të ecurisë së punimeve për të gjitha projektet, pranime teknike për projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive tjera si dhe benë inspektime në teren sipas kërkesave të palëve;

Gjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021 në këtë drejtori janë pranuar 941 lëndë si: kërkesa për leje ndërtimi, kërkesa për kushte ndërtimi, kërkesa për leje mjedisore komunale, kërkesa për legalizim, fatura dhe kërkesa të natyrave të ndryshme.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ka vendosur si me poshtë:

608 lëndë të miratuara, prej të cilave janë 60 leje ndërtimi, 64 kushte të ndërtimit, 8 leje mjedisore, 13 leje legalizimi, 8 referenca, 162 vërtetime, 2 pëlqime, 298 lëndë, procesverbale, vendime, fatura, njoftime, shkresa dhe kërkesa të ndryshme.

277 lëndë janë në shqyrtim, 10 lëndë të refuzuara, 26 lëndë të pezulluara, 6 lëndë të hedhura poshtë, 6 lëndë të anuluar, 8 të pranuar. Drejtoria këtë vit ka krijuar të hyra buxhetore në vlerë prej 183.241,78 euro nga lejet e ndërtimit, kushtet e ndërtimit, lejet mjedisore komunale, legalizimi pëlqimet, etj. Kjo drejtori ka bërë regjistrimin e të gjitha rrugëve në sistemin e adresave dhe 90% e të hyrjeve të objekteve.

Drejtoria ka menaxhuar, mbikëqyrur dhe realizuar projektet si me poshtë:



**Projektet kapitale 2020-2021 dhe 2021-2022:**

Emri i projektit	Gjatësia m	Investimi komuna	Investimi	Planifikimi i realizimit	Realizimi i projekti t
Asfaltimi i rrugës dhe infrastruktura nëntokësore në Pjetërq - faza 2	3915,00 3260,00	Komuna		2020-2021	përfunduar
Asfaltimi i rrugës Stupë-Zajm - faza 3	7312,00		Ministria e Infrastrukturës	2020-2021	vazhdon
Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktura nëntokësore në qytetin e Klinës	4633,00 405,00	Komuna		2020-2021	përfunduar
Studimi i fizibilitetit për trajtimin e ujërave të zeza.		Komuna		2020-2021	përfunduar
Ndërtimi i stacionit të autobusëve të autobusëve.		Komuna		2020-2021	përfunduar
Ndërtimi i kanalizimit Klinë-lagjja Arbëria	767,00	Komuna		2020	përfunduar
Ndërtimi i liqenit akumulues	1550,00	Komuna		2020-2021	vazhdon
Ndërtimi i kanalizimit Dollovë - Faza 2	1739,00	Komuna		2020	përfunduar
Asfaltimi i rrugëve Shtupel -Kernicë	5294,00	Komuna		2020-2021	përfunduar

Nr.	Emri i kontratës	Vlera kontratës	Të paguara në vitin 2021	Të paguara deri me tani	Puna shtesë	
1	Asfaltimi i rrugëve në Përqevë	€ 89,000.00	€ 80,100.00	84,199.09 €	4,099.09 €	pranim teknik

2	Asfaltimi i rrugëve Gjurgjevik i Vogël - Klinafc	€ 43,643.53	€ 45,000.00	45,000.00 €	3,406.60 €	pranim teknik
3	Asfaltimi i rrugëve Caravik - Qabiq	€ 88,215.00	€ 54,007.28	54,007.28 €	8,760.00 €	pranim teknik
4	Ndërtimi i ujësjellësit Gllarevë	€ 99,953.70	€ 70,000.00	70,000.00 €	0.00 €	vazhdim
5	Asfaltimi i rrugës i Jashanicë-Resnik - Faza dytë	€ 141,141.00	€ 45,000.00	45,000.00 €	0.00 €	vazhdim
6	Asfaltimi i rrugës Pjetërq - Dugajevë - faza dytë	€ 22,307.40	€ 17,252.42	17,252.42 €	0.00 €	pranim teknik
7	Asfaltimi i rrugës i Sferkë-Volljak-Qupevë-faza e dytë	€ 78,888.88	€ 45,000.00	45,000.00 €	0.00 €	vazhdim
8	Asfaltimi i rrugëve Videjë-Budisalc-Berkovë-Klinafc - Ministria	€ 49,964.08	€ 49,964.08	49,964.08 €	0.00 €	pranim teknik

Nr.	Emri i kontratës	Vlera e kontratës	Punë shtesë	Totali i pagesave për vitin 2021	pranim teknik/vazhdon
1	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore në fshatin Pjetërq-Dugajevë	€ 41,869.70	€ 4,095.44	€ 45,965.14	pranim teknik
2	Asfaltimi i rrugëve Zabergj, Rixhevë, Gllarevë, Stapanicë	€ 69,690.90	€ 6,340.74	€ 76,031.64	pranim teknik
3	Asfaltimi i rrugës dhe infrastrukturës në qytet – aksi te xhamia	€ 44,605.44	€ -	€ 44,605.44	pranim teknik
4	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Klinë-Dresnik-Dollc	€ 599,999.99	€ -	€ 204,624.00	vazhdon
5	Asfaltimi i rrugëve lokale në Dobërdol	€ 49,529.25	€ -	€ 34,998.77	pranim teknik



6	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë	€ 140,662.42	€ -	€ 31,238.46	vazhdon
7	Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore në fshatrat Gllarevë, Rixhevë e Zabergj	€ 9,341.11	€ -	€ -	vazhdon
Totali:		€ 955,698.81	€ 10,436.18	€ 437,463.45	

Nr.	Emri i kontratës	Vlera e kontratës	Totali i pagesave për vitin 2020 nga komuna	Totali i pagesave për vitin 2021 nga ministria	Totali i pagesave për vitin 2021 nga komuna	Pranim teknik/vazhdon
1	Asfaltimi i rrugëve lot1-rruga dhe infrastruktura nëntokësore Videjë-Jagodë-Paskalicë-Krushevë e Madhe	€ 97,873.80	€ -	€ 55,000.00	€ 33,086.42	pranim teknik
2	Lot2- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Jagodë-Budisalc-Bërkovë-Klinë	€ 54,830.64	€ -	€ -	€ 54,830.64	pranim teknik
3	Asfaltimi i rrugëve lot 1 - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shtupel-Kërmicë	€ 95,179.50	€ -	€ -	€ 41,259.05	vazhdon
4	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gjurgjevik i Madh	€ 24,999.99	€ -	€ 10,000.00	€ 14,566.49	pranim teknik

5	Asfaltimi i rrugëve, infrastrukturës nëntokësore në fshatrat Ujmirë-Siqevë-Shtaricë - Faza e dytë	€ 98,787.57	€ -	€ -	€ 28,330.00	vazhdon
6	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Bërkovë	€ 13,797.00	€ -	€ -	€ 13,797.00	pranim teknik
7	Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë- Faza e parë	€ 83,800.35	€ 5,000.00	€ -	€ 58,800.04	vazhdon
totali:		€ 469,268.85	€ 5,000.00	€ 65,000.00	€ 244,669.64	

Gjatë periudhës një vjeçare janë asfaltuar 27,9 km rrugë dhe janë punuar 9432 metra kanalizim fekal. Gjatë kësaj periudhe punëtorët e drejtorisë kanë marr pjesë në komisione për hapje dhe vlerësime të ofertave për projekte të ndryshme. Janë mbajtur takime të ndryshme me donatorë si dhe dikasteret e linjës, me qëllim të harmonizimit të punëve si dhe përfitimit të projekteve të ndryshme. Janë mbajtur takime të rregullta me kompanitë si "Hidrodrini", KRM "Ambienti", KEDS, PTK, që të na ofrojnë të gjitha projektet që kanë planifikuar për komunën e Klinës. Gjatë kësaj periudhe është bërë raporti vjetor i punës për vitin 2020, raporte mujore rreth punës së drejtorisë. Janë bërë vlerësimet dhe sistemimet e dosjeve të këtij viti si dhe punë tjera që kanë të bëjnë me planifikimin, detyrat dhe aktivitetet e drejtorisë. Është bërë shënimi i datave mjedisore, siç është: Dita e Tokës - 22 prilli, "Ta pastrojmë Kosovën 24 maji", Dita e Mjedisit - 5 qershori. Drejtoria ka bërë edhe punë tjera, si inspektime në teren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe paralogari për rrugë, rrënim të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, detyra projektuese, kërkesa, projekt-propozime, raporte, mbikëqyrje të projekteve, pranime teknike etj.



## **5. DREJTORIA E ARSIMIT**

Drejtoria e Arsimit gjatë vitit 2021, në përputhje me parimet dhe qëllimet e ligjit të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, të ligjit për arsimin në komunat e republikës së Kosovës, të ligjit të punës, bazuar në dispozitat e UA të MPMS-së 07/2017 për procedurat e konkursit në sektorin publik, për rekrutim të personelit sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve edukativo-arsimore, pastaj mbështetur në planin e punës për 2021, në rregulloren unike komunale për personel dhe nxënës, në strategjitë komunale dhe qeveritare, në dokumentet bazë të kurrikulës si dhe në përputhje me kërkesat e shkollave dhe të problemeve që kanë kërkuar zgjidhje, ka realizuar dhe ka bashkëndëruar aktivitete me MASH-in, komunën, organizata kompetente dhe partnerë të tjerë zhvillimorë në fusha si më poshtë, por duke pasur parasysh dhe duke respektuar masat qeveritare anti COVID-19 dhe sugjerimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, duke monitoruar situatat në bashkëpunim me task forcat shkollore dhe task forcën komunale, duke respektuar udhëzuesin përgjithshëm të MASH-it për organizimin e procesit mësimor në vitin shkollor 2021/2022 në kushte të pandemisë COVID-19:

1. Ngritja e shkallës së cilësisë në procesin mësimor.
2. Krijimi i hapësirave shkollore sa më të përshtatshme për procesin mësimor.
3. Bashkëpunimi me koordinatorë të cilësisë të shkollave për zbatim të kurrikulës, përfshirë edhe procesin e vlerësimit dhe instrumenteve të tij.
4. Gjithëpërfshirja në arsim.
5. Ngritja e nivelit të ndërkomunikimit dhe bashkëpunimit të shkollës me komunitetin.
6. Koordinimi i aktiviteteve me asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me mësuesit mbështetës për identifikimin dhe vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ofrimi i shërbimeve pedagogjike për këta fëmijë nga institucioni arsimor.
7. Koordinimi i aktiviteteve me MASH-in për organizimin dhe administrimin e vlerësimit të jashtëm (testit nacional të klasës 9 dhe provimit të maturës shtetërore).
8. Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit edukativo-arsimor.
9. Vizita të përgjithshme këshilluese e monitoruese në institucionet arsimore.
10. Përcjellja dhe realizimi projekteve të realizuara në shkolla.

Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore në komunën tonë është realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik operojnë në terren dhe përcjellin nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale.

Drejtoria e Arsimit ka shtuar bashkëpunimin me partnerë kompetentë dhe me palë të ndryshme të interesit në arsim, po ashtu ka ndikuar që të kemi një performancë më të mirë në institucionet arsimore sa i përket vetëdijesimit të nxënësve për natyrën dhe rëndësinë e të drejtave të fëmijëve dhe të njeriut, pastaj për kulturën ekologjike dhe për krijimin e një ambienti krejtësisht pa të gjitha llojet e dhunës në shkollë dhe jashtë saj.

Sa i përket zbatimit të kurrikulës, me fokus vlerësimin e nxënësve, DKA-ja u ka dërguar shkollave, sipas MASH-it, kërkesën me shkrim që të marrin informata kthyesë nga mësuesit se a kanë hasur në vështirësi dhe në çfarë vështirësish gjatë procesit të vlerësimit të nxënësve sipas ua 08/2016 për vlerësimin e nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës së re, në mënyrë që MASH-i të njoftohet dhe të bëjë një analizë të gjendjes se a ka nevojë që ky udhëzim administrativ të rishikohet apo jo.



DKA-ja, sipas planit të punës, ka bërë monitorimin e shkollave sipas kompetencave ligjore, ka identifikuar nevojat e ndryshme materiale dhe ato në lidhje me procesin mësimor, avancimin e cilësisë në mësimdhënie e nxënie si dhe nevojat për trajnim të vazhdueshëm të personelit mësimor.

Të gjitha shkollat janë furnizuar me dezinfektues dhe pako higjienike nga një donacion i UNICEF-it si dhe nga furnizimet e komunës. Po ashtu, sipas kërkesave të shkollave dhe ndihmës së MASH-it, institucionet shkollore kanë pranuar 25 pajisje elektronike (tablete) për fëmijë me nevoja të veçanta që nuk kanë kushte të mira ekonomike për të ndjekur mësimin në distancë.

Duhet theksuar se pandemia, ashtu sikur edhe në sektorë të tjerë, ka rënduar gjendjen në sistemin e arsimit, sepse ka prekur në etapa të tri viteve shkollore (2019/2020, 2020/2021, 2021/2022) dhe me gjithë kujdesin dhe menaxhimin e procesit mësimor, me gjithë kujdesin e institucioneve lokale dhe qendrore ndaj shëndetit të fëmijëve dhe personelit arsimor, gjendja pandemike ka kufizuar shumë aktivitete të rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve dhe avancimin e tyre, pastaj mësimi në distancë dhe on-line, sikur gjithkund tjetër në botë, nuk i ka dhënë efektet e dëshirueshme dhe të pritshme për prindër dhe personel.

Sipas programit smia në institucionet edukativo-arsimore të komunës së Klinës në vitin shkollor 2021/2022 vijojnë procesin mësimor 7055 fëmijë (vitin e kaluar 7515, pra sivjet 460 më pak). prej këtyre 3501 ose 49.62 % janë femra. nxënës romë, egjiptianë dhe ashkali janë 238 ose 3.37 %. në vitin shkollor 2020/2021 nxënës braktisës janë 36 (3 nga gjimnazi dhe 36 nga shmp-ja). në të gjitha institucionet edukativo-arsimore në vitin shkollor 2021/2022 punojnë 673 punonjës, prej tyre 284 ose 42.19 % femra.

### ***Bashkëpunimi dhe koordinimi***

Në kuadër të garave tradicionale më 20 shkurt 2021 është mbajtur Olimpiada Matematike e Kosovës në nivel komunal me nxënës të klasave 9,10,11 e 12, kurse më 21 shkurt u mbajt gara e fizikës në nivel komunal me nxënës të klasës 9.

On-line është mbajtur trajnimi për ekipet për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta më 22, 23 e 24 shkurt, kurse më 27 e 28 shkurt, po ashtu on-line, është mbajtur trajnim me mësimdhënës të biologjisë për çështje të ndryshme të fushës së shëndetit të njeriut. Në qendrën didaktike në Pejë është mbajtur trajnimi për udhëheqje arsimore, në nivel rajonal, organizuar nga MASH-i. Nga Klina morën pjesë 6 mësimdhënës. arsimtarët e biologjisë dhe ata të edukatës fizike kanë marrë pjesë në një trajnim on-line për shëndetin riprodhues, organizuar nga organizata KOPF.

Më 7 maj 2021 u mbajt testimi pilot për PISA 2022 në lokale të SHMP "Fehmi Agani" në Klinë, ku hynë në testim on-line 56 nxënës 15 vjeç të gjimnazit "Luigj Gurakuqi" të Klinës, të lindur ndërmjet datave 1.1.2005 dhe 31.12.2005, të përzgjedhur nga MASH-i.

Më 10 qershor në mjedise të shkollës së mesme profesionale "Fehmi Agani" është mbajtur një takim informues me administruesit e provimit të maturës shtetërore 2021. Prezantoi edhe përfaqësuesi i komisionit shtetëror të maturës. Ndërsa, sipas sugjerimeve të MASH-it më 11 qershor në të gjitha institucionet edukativo-arsimore janë mbajtur ligjërata, debate dhe aktivitete të tjera për nder të 12 qershorit-ditës së paqes dhe të ditës ndërkombëtare kundër



punës së fëmijëve, mbështetur edhe në platformën endchildlabour të MASH-it, MBZHR-së, SBASH-ut, UP-së (Fakultetit të Edukimit) dhe të koalicionit të OJQ-ve për mbrojtje të fëmijëve.

Më 18 qershor është mbajtur testimi ndërkombëtar PRILS (progresi në studimin ndërkombëtar të shkrim-leximit) me nxënës të klasave të katërta (gjithsej 102 nxënës të përzgjedhur nga MASH-i) të shkollës “Ismet Rraci” dhe “Atë Shtjefën Gjeçovi”. Ky testim ndërkombëtar organizohet nga IEA (Organizata Ndërkombëtare për Vlerësimin në Arsim). Testimi mat arritjet e nxënësve të klasave të katërta në fushën e leximit dhe të përvetësimit të kërkesave arsimore e të mendimit logjik e të pavarur që nxitet nga të lexuarit.

Më 28, 29 e 30 qershor ka qenë i hapur konkursi publik për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë.

Gjatë korrikut kanë vazhduar punët dhe aktivitetet e DKA-së në koordinim me struktura të tjera lokale e qeveritare për përgatitjet rreth fillimit sipas kalendarit të MASH-it të vitit shkollor 2021/2022. Në kuadër të kësaj fushe DKA-ja më datën 1 korrik 2021 ka mbajtur takim të rregullt pune me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore ku janë trajtuar e debatuar çështje të ndryshme dhe të rëndësishme të përfundimit të vitit shkollor 2020/2021 si dhe kërkesa po ashtu të rëndësishme që kanë të bëjnë me fillimin e vitit të ardhshëm shkollor.

Më 30 gusht kompanitë që janë kontraktuar nga MASH-i- Dukagjini dhe Albasi- kanë filluar të sjellin tekste shkollore për klasat 1-5 dhe tekste alternative të përzgjedhura nga shkollat për klasën 6 dhe 7.

Në muajin shtator DKA-ja ka përsheptuar punët dhe ka qenë në koordinim të vazhdueshëm me drejtorë të shkollave dhe MASH-in që të jetë e gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021 i cili, sipas kalendarit të MASH-it duhej të fillonte më 1 shtator, por për shkak të situatës së rënduar epidemiologjike dhe sipas rekomandimeve të IKSHPK-së ka filluar më 27 shtator 2021. 18 ditët e humbura të këtij viti shkollor do të zëvendësohen të shtunave duke filluar qysh nga data 9 tetor 2021 dhe në vazhdim, sipas planit të MASH-it, që u është shpërndarë të gjitha institucioneve të arsimit parauniversitar.

Më 6 shtator 2021, pas shqyrtimit të ankesave nga komisioni ad-hoc, komisioni përzgjedhës ka shpallur listën definitive të 30 studentëve përfitues të bursës komunale për vitin akademik 2020/2021 në vlerë prej 50 € në muaj me kohëzgjatje njëvjeçare.

Trajnimet gjashtëditore për zbatimin e kurrikulës kanë filluar më 8 shtator 2021 në SHFMU “Ismet Rraci” të Klinës për të gjithë mësimdhënësit që në vitin shkollor 2020/2021 do të punojnë me grup-moshat e fëmijëve parafillorë, me klasën e parë, të gjashtën dhe të dhjetën për të gjitha fushat kurrikulare.

Kurse British Council (Prishtinë) në bashkëpunim me MASH-in ka kërkuar nga DKA-ja dhe nga shkollat bashkëpunim për realizimin e sfidës/garës nacionale të kodimit 2021 për shkollat e mesme të ulëta që kanë mbaruar trajnimin e programit ‘shkollat e shekullit 21’ dhe të cilat do të aplikojnë me projektet e tyre.

Sikur edhe viteve të tjera, fondi “Çifti Buçinca” në bashkëpunim me organizatën Rotary Club Prishtina International dhe Virum Sorgenfri Rotary Club nga Danimarka, ka vendosur që 4 nxënësve të klasës 10, 2 nga gjimnazi dhe 2 nga SHMP-ja, që vijnë nga zonat rurale, t’u japë bursë me vlerën prej 40 € në muaj deri në përfundim të shkollimit të mesëm të lartë.



Më 15 shtator DKA-ja ka pranuar një donacion prej 8800 maskash anti-covid nga regjimenti i dytë i këmbëtorisë së forcës tokësore në Istog që është pjesë e kazermës “ushtarët e NATO-s”

Më 27 tetor 2021 MASH-i ka vendosur sipas kërkesës së këshillit drejtues të shkollës së Përçevës dhe të DKA-së për pavarësimin e kësaj shkolle ose për themelimin e SHFMU të Përçevës e cila deri para këtij vendimi ishte paralele e ndarë e SHFMU “Dëshmorët” të Volljakut. Ky vendim i MASH-it mban numrin e protokollit 2-1830 dhe datën 27.10.2021. Këshilli drejtues i kësaj shkolle dhe DKA-ja do të vazhdojnë me procedurat ligjore për emërtimin e kësaj shkolle me vendim të MASH-it.

Sa i përket avancimit të gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor, MASH-i ka siguruar për komunën e Klinës shumën e mjeteve buxhetore prej 23.628.00 € për pagat e 3 asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, të cilët do të pranohen në punë për vitin 2022 sipas procedurave të konkursit publik dhe në përputhje me nenin 8, pikën 6 të ua 05/2021 të MASH-it për normativin për kuadrin profesional në arsimin e përgjithshëm. paga mujore e asistentit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore është 397.01 €.

Më 6 dhjetor 2021, në sallën e kuvendit të komunës, organizata “Human” ka zhvilluar një aktivitet me rastin e ditës (javës) ndërkombëtare kundër korrupsionit (6-11 dhjetor), ku janë shpërndarë materiale sensibilizuese dhe janë lexuar esetë më të mira nga gara ku kanë qenë të përfshirë nxënës të gjimnazit “Luigj Gurakuqi”. Në këtë ditë janë mbjellë edhe disa fidanë në hapësirën e këtij gjimnazi.

Më 29 dhjetor drejtori i DKA-së ka mbajtur takim pune me përfaqësuesen e organizatës suedeze “The Library Project-Kosova” rreth organizimit dhe zhvillimit të projektit “Ora e leximit” që ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të mësuesve në shkencën e të kuptuarit të leximit përmes trajnimeve si dhe rritjen e investimeve në qasje dhe cilësi të programeve të leximit në institucione shkollore dhe biblioteka publike. Donator i projektit është fondacioni kosovar për shoqëri civile, programi “Eja Kosovë”, kurse bashkëfinancues janë: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SCD), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. DKA-ja dhe kjo organizatë do të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve rreth këtij projekti ku janë përfshirë shkolla “Motrat Qiriazi” e Klinës dhe ajo “Atë Shtjefën Gjeçovi” e Zllakuqanit me mundësi të zgjerimit të rrjetit të shkollave që do të përfitojnë nga ky projekt. Kjo organizatë vepron në Kosovë që nga viti 2017 dhe projektin e vet në shërbim të librit ka filluar ta zbatojë për herë të parë në SHFMU “Azem Bejta” të Grabanicës.

### **realizimi i projekteve kapitale 2021**

Buxheti kapital për vitin 2021				
nr.	Përshkrimi	Mjetet e aprovuara	Mjetet e realizuara	Mbetja
1	Furnizim me pajisje kabinetike	30000	30000	0
2	Furnizim me inventar	20000	20000	0



3	Rinovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive	170000	168275.2	1724.8
Totali		220000	218275.2	1724.8

**Sqarim:** Mbetja prej 1724.8 euro arsyetohet se kontrata nga projekti "Rinovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive", konkretisht renovimi i tualeteve në SHFMU Volljakë është ndërprerë për arsye se kompania nuk i ka përfunduar me kohë punimet.

### Vlerësimi i brendshëm

Suksesi në nivel komune në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020/2021 (31 gusht 2021).

Shkelq.		Sh.mirë		Mirë		Mjaft.		Përserit		Pa notë		Përcillen		1 e dob.		2 dob.		3
f	gj	f	gj	f	gj	f	gj	f	gj	f	gj	f	gj	f	gj	f	gj	f
193	375	40	104	21	52	8	20	0	1	0	5	0	0	0	0	0	0	0
173	334	37	80	24	62	12	37	0	0	2	3	0	0	0	0	0	0	0
190	346	58	112	28	63	19	48	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0
207	367	70	140	34	95	16	37	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0
189	330	59	114	25	74	9	37	0	0	3	5	2	4	0	2	0	1	0
130	209	69	140	37	106	14	71	1	1	1	1	0	0	3	5	2	5	0
126	201	82	126	66	165	20	102	1	3	1	2	0	0	0	2	0	1	0
130	197	84	149	57	165	16	104	4	4	0	2	0	0	1	9	1	5	0
166	232	65	134	57	158	18	73	1	3	1	6	0	0	1	6	0	10	0
54	68	71	109	74	143	34	112	3	29	0	1	0	0	3	8	1	3	8
76	96	75	103	66	139	52	174	3	16	0	0	0	0	0	2	0	5	0
82	99	84	98	71	141	31	130	1	3	0	0	0	0	5	11	2	5	0
1716	2854	794	1409	560	1363	249	945	14	60	10	27	3	5	13	45	6	35	8

Me sukses pozitiv 6571 nxënës ose 97.29 %.

### Vlerësimet e jashtme

Rezultatet e testit të arritshmërisë të klasës 9, mbajtur më 28 maj 2021

nr.	Institucioni			Nx.në testim	Poenat	Arritshmëria
	Shkolla	Vendi	Kodi			
1	"Ismet Rraci"	Klinë	1	132	7695	58.30
2	"Emin Duraku"	Sferrkë	2	42	2151	51.21
3	"Motrat Qiriazi"	Klinë	3	62	3540	57.10
4	"Ali Krasniqi"	Ujmirë	4	11	497	45.18
5	"Azem Bejta"	Grabanicë	5	36	1601	44.47
6	"D. e Qëndresës"	Gllarevë	6	42	2135	50.83
7	"Tre Dëshmorët"	Jashanicë	7	46	1887	41.02
8	"A. Sh. Gjeçovi"	Zllakuqan	8	32	2210	69.06
9	"Avni Zhabota"	Shtupel	9	19	906	47.68
10	"Esad Mekuli"	Caravik	10	24	927	38.63
11	"Zgjimi"	Gremnik	11	21	927	44.14
17	"Isa Boletini"	Drenoc	12	33	1498	45.39
13	"Nënë Tereza"	Budisalc	13	6	236	39.33
14	"Ymer Berisha"	Siqevë	14	8	349	43.63
15	"A.Gjergj Fishta"	Jagodë	15	12	595	49.58
16	"Dëshmorët"	Valljak	16	34	1392	40.94
17	"Dëshmorët e Kombit"	Çabiq	17	23	1101	47.87
	<b>Gjithsej</b>			<b>583</b>	<b>29647</b>	<b>50.85</b>

Më 2019 përqindja e arritshmërisë ishte 54.92 %, kurse më 2020 testi nuk është mbajtur për shkak të pandemisë covid-19

#### Rezultatet e provimit të maturës shtetërore 2021, 26 qershor 2021 (afati i parë)

Gjimnazi "Luigj Gurakuqi"			
U testuan	Kaluan	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
238	209	29	87.82



<b>SHMP "Fehmi Agani"</b>			
U testuan	Kaluan	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
211	144	67	68.25
<b>Shkolla e mjekësisë "Keka Med"</b>			
U testuan	Kaluan	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
39	29	10	74.36
U gjithsej	Kaluan gjithsej	Mbeten për afatin tjetër	% në nivel komunal
488	382	106	78.28

Vitin e kaluar: gjimnazi 91.53; SHMP 32.03; "Keka Med" 70.37; në nivel komune 62.55

Rezultatet e provimit të maturës shtetërore 2021, 28 gusht 2021 (afati i dytë)

<b>Gjimnazi "Luigj Gurakuqi"</b>			
U testuan	Kaluan	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
24	22	2	91.67
<b>SHMP "Fehmi Agani"</b>			
U testuan	Kaluan	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
75	40	35	53.33
<b>Shkolla e mjekësisë "Keka Med"</b>			
U testuan	Kaluan	Mbeten për afatin tjetër	% e kalueshmërisë
6	6	0	100.00
U gjithsej	Kaluan gjithsej	Mbeten për afatin tjetër	% në nivel komunal

105	68	37	64.76
-----	----	----	-------



6. DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI



Në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi edhe gjatë vitit 2021 kanë funksionuar:

- Puna gjeodezike, që nënkupton dokumentacionin teknik gjeodezik për punët e kryera themelore gjeodezike, matjen e pronave të paluajtshme në funksion të kadastrës së palujtshmërive dhe në funksion të mbajtjes së kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës.

Pra, shërbimi për punë kadastrale dhe gjeodezike gjatë kësaj periudhe konform normatives për punët kadastrale dhe gjeodezike ka bërë përpjekje për kryerjen e punëve me afat të caktuar kohor. Gjatë periudhës njëvjeçare, janar–dhjetor 2021, drejtorisë i kanë arritur 3681 kërkesa të ndryshme dhe të gjitha janë regjistruar, evidentuar, protokolluar, kompletuar e shqyrtuar si lëndë të palëve në procedurë.

Prej tyre janë:

- ❖ Për nevoja të ndryshme të qytetarëve, palëve janë identifikuar (caktuar pas konstatimit), nxjerrur, përshkruar, korrigjuar, vërtetuar dhe lëshuar në qarkullim zyrtar fletëposedime dhe kryer identifikimin me konstatim në toka, deshifruar dhe vizatuar – punuar me përshkrim të plotë në tërësi kopje plani me pagesë dhe certifikata që pala nuk posedon pronë për nevoja personale për nevoja të ndryshme, duke i vërtetuar në përputhshmëri me gjendjen në evidencën kadastrale, gjithsej janë 5394.
- ❖ Sipas evidencës zyrtare dhe në pajtueshmëri me dokumentacionin përgjegjës janë dhënë, lëshuar për raste sociale pa pagesë 269– të gjitha të regjistruara dhe të protokolluara.
- ❖ Bazë për ndërrime, ndryshimin e pronarit të tokës apo pjesëve të pronave në operatin kadastral janë aktvendimet, historiate, ekspertiza dhe marrëveshjet e plotfuqishme të gjykatave ose organeve tjera kompetente. Në periudhën raportuese janë punuar te drejtoria 527 lëndë.

Gjatë periudhës raportuese janë kryer disa punë tjera që tani në pamundësi evidencimi, si shërbime të kryera për mungesë të normave adekuate siç janë kërkesat e shumta të përditshme të palëve për vend-shikim të operatit kadastral, elaborateve dhe planeve me qëllim të marrjes së informative të caktuara mbi gjendjen e pronësisë, saktësisë së evidencës mbi ndryshimet që paraqiten të cilat janë të pamundura të regjistrohen. Çdo qytetarë do të informohet me kohë nga zyrtarët e sportelit për lëndën e tyre se a është përfunduar, a është në proces apo është refuzuar dhe qytetari do të informohet për arsyet e refuzimit të kërkesës së tij.

*Raport financiar për janar – dhjetor – 2021*

Zyra për pranimin e palëve: certifikatën e pronësisë (fleta poseduese)	3922 fleta poseduese janë lëshuar gjatë vitit 2021
kopje plani	1349 kopje plani janë lëshuar gjatë vitit 2021
certifikata që nuk posedon pronë	123 certifikata që nuk posedon pronë janë lëshuar gjatë vitit 2021
Të hyrat vjetore në Drejtorinë për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronësi nga zyrtaret në sportel, gjeodetët dhe zyrtares përgjegjëse.	66. 520,00 euro



## **7. DREJTORIA E INSPEKTORATIT**

Duke u udhëhequr nga parimet themelore të ligjshmërisë, mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe interesave publike të tij, efikasitetit, dëgjimit të palëve në procedurë, vlerësimin të lirë të dëshmimeve, mëvetësisë në vendosje, plotfuqishmërisë së aktvendimeve, ekonomizimit të procedurës dhe parimit të dyshkallëshmërisë, Drejtoria e Inspektoratit ka përmbushur planin e vet të punës në pikat më kyçe. Plani njëvjeçar i përgjithshëm edhe pse ka qenë i detajuar sipas specifikave të sektorëve, i'u është përshtatur veprimeve sipas kohës dhe karakteristikave që janë imponuar në realizimin e tij. Bazën për punën dhe aktivitetin e vet veprues kjo drejtori e ka mbështetur në ligjet e nxjerra nga kuvendi i Republikës së Kosovës, udhëzimet administrative përkatëse për jetësimin e tyre, statutin e komunës, rregulloret komunale si dhe aktet dhe nënaktet tjera ligjore që i'u dedikohen zbatimit të tyre.

Funksioni themelor i këtyre organeve në kuadër të kësaj drejtorie për periudhën raportuese është manifestuar në mbikëqyrjen-kontrollin inspektues të zbatimit të ligjshmërisë nga lëmi i shërbimeve publike, ndërtimit, bujqësisë dhe ambientit, tregut, trafikut sanitar dhe atij financiar-legalizimit të ushtrimit të aktivitetit biznesor të subjekteve ekonomike dhe joekonomike, etj.

Me qëllim të sendërtimit të strategjisë afatgjate në jetësimin e sundimit të ligjit dhe luftimin e informalitetit-veprimeve kundërligjore të subjekteve që i'u nënshtrohen kontrollit inspektues, organet e drejtorisë në periudhën raportuese kanë ndërmarr një serë aktiviteteve dhe veprimesh koordinuese në bashkëveprim edhe me Policinë e Kosovës në: kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, kontrollin e bizneseve, mbikëqyrjes së rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK-së, KEDS-it, dëmtimeve eventuale të rrugëve, trotuareve, hapësirave publike, respektimit të orarit të punës së bizneseve hoteliere, sidomos gjatë punës në orët e vonshme të natës, mbarëvajtjes së tregjeve javore, mbikëqyrjen e transportit publik, mbikëqyrjen e pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit, kontrollin e artikujve ushqimor dhe të konsumit ditor nga aspekti i rregullsisë shëndetësore dhe afatshmërisë të përdorimit të tyre. Kurse, ndërlidhur me këtë, nga ana e drejtorisë janë nxjerr një numër i konsideruar i akteve-urdhërësive ekzekutuese për eliminimin e lëshimeve të konstatuara. Këtu duhet shtuar se organizimi i punëve dhe detyrave të punës nga ana e eprorit të organit dhe inspektorëve, pos punëve të ushtruara në orarin e rregullt të punës, është bërë edhe gjatë ditëve të vikendit, festave fetare dhe shtetërore dhe me caktimin e kujdestarive si dhe punës në grupe.

Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera për taksat, tarifat dhe ngarkesat si dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet e shkaktuara ligjore është inkasuar shuma prej 6543.00 euro në emër të gjobave mandatore dhe 2387.00 € në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjieno-teknike të hapësirave punuese-lokaleve në të cilat ushtrohet aktiviteti ekonomik nga inspektori sanitar dhe inspektori i tregut.

Nga personat fizik dhe ata juridik në nivel të drejtorisë janë proceduar 320 kërkesa të ndryshme, nga të cilat janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore 100. Janë refuzuara si të pabazuara 3, 15 janë në procedurë, ndërsa 18 në pritje.

Me qëllim të informimit të ndërsjellë në relacionin organet e inspektoratit dhe drejtoria në raport me drejtoritë tjera dhe kryetarin e komunës si dhe në vijën vertikale në raport me Qeverinë dhe ministritë gjegjëse, janë hartuar informata, raporte, memorandume dhe relacione tjera zyrtare në kërkesë të tyre dhe ato sipas detyrës zyrtare.



Duke perceptuar dhe shqyrtuar aspektet dhe veprimet e sipërshënuara, pashmangshëm rrjedh konstatimi i paraqitjes edhe të vështirësive dhe pengesave tjera që shfaqen përgjatë ushtrimit të kontrollit inspektues, sidomos në numrin jo të mjaftueshëm të inspektorëve krahasuar më numrin e banorëve në komunën tonë. Mosplotësimi i vendit vakant të punës së inspektorit shërbimeve publike, demotivimi për punë nga pasoja shpërblimit jo adekuat krahasuar me punën e tyre/përgjegjësitë, punën jashtë orarit dhe rrezikshmërinë e ushtrimit të funksionit të tyre nga shkak i kufizimeve buxhetore.

Në vijim paraqitet në vija të shkurtra puna veç e veç e secilit organ të inspektoratit pa pretenduar që të shkoqiten punët dhe aktivitetet e tyre rutinore dhe në detaje e që janë të përcaktuara në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

### ***Inspektimet nga lëmia publike***

Në këtë lëmi në periudhën raportuese janë ushtruar mbikëqyrje inspektuese e që ka rezultuar me procesverbale të përpiluara në vend. Në objektiv të kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit, ai elektrik, i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektorët tjerë në aksione të përbashkëta, dalja në vend dhe shqyrtimi-trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizik dhe juridik të natyrës përkatëse.

### ***inspektimet nga lëmi i ndërtimit.***

Në këtë aspekt, duke ushtruar mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore të ndërtimit janë ushtruar 150 kontrole dhe janë hartuar 80 procesverbale në vend dhe janë iniciuar 11 procedura për kundërvajtje.

Po ashtu, është koordinuar dhe bashkëvepruar me inspektorët tjerë në kuadër të drejtorisë në punët e përbashkëta, sidomos në kontrollin e përgjithshëm për mbrojtën nga pandemia COVID-19, punët e tregjeve javore, transportin e kombibusëve, etj. Janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 400 euro.

### ***Inspektimi në lëmin e komunikacionit***

Ky organ në vitin raportues ka ushtruar mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtja e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, vendosja në kërkesat e palëve etj. Në lidhje me këtë janë hartuar 7 procesverbale si dhe janë evidentuar monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve si brenda lokalitetit të Klinës ashtu edhe jashtë saj, përkatësisht të qendrave të lokalitetit në territorin e komunës së Klinës. Është asistuar në vendosjen dhe shenjzimin e shenjave vertikale dhe horizontale nga kompania fituese e tenderit përkatës në qytezën e Klinës dhe jashtë saj. Po ashtu, është bashkëvepruar me organet tjera inspektuese në aksione të përbashkëta të planifikuara nga drejtorja.

### ***Inspektimi nga lëmi i bujqësisë dhe ambientit.-***

Gjatë periudhës raportuese nga lëmi i inspeksionit të bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar 198 inspektime dhe po aq procesverbale, prej tyre 22 kërkesa, 4 furra të bukës, 27 gurëthyes, 6 seperacione, 8 korrje-shirje, 49 eksplantim i zhavorrit, 33 hedhje dhe djegie të mbeturinave, 28 dëmet nga vërshimet si dhe 21 gjoba të shqiptuara në vlerën prej 3655 euro.



### ***Inspektimi në lëminë sanitare***

Në zbatim të dispozitave nga lëmi i mbikëqyrjes sanitare dhe të mbrojtjes shëndetësore të popullatës Ligji nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 të kushtetutës së Republikës së Kosovës, atij për duhanin si dhe aktet tjera të kësaj lëmie, inspektori sanitar ka ushtruar 430 mbikëqyrje inspektuese dhe ka përpiluar 220 procesverbale mbi konstatimin e gjendjes në vend. Varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKSHPK-së janë nxjerrë 1800 vendime për vetizolim dhe 1800 vendime për lirim. Të vdekur nga pandemia covid-19 janë 20 persona. Është përcjellë ceremonia e varrimit, në bashkëpunim me policinë. Janë marrë mostra të analizës së ushqimit, janë iniciuar procedura për kundërvajtje në Gjykatën Themelore – dega në Klinë. Është punuar aktivisht në transmetimin dhe jetësimin e fushatës parapërgatitore në aplikim të dispozitave ligjore të duhanit si dhe për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia covid-19. Është punuar intenzivisht në rrjetin e objekteve hoteliere, ashtu edhe në objektet shkollore private dhe publike të komunës. Pjesëmarrja në komisionin vlerësues të përcaktimit të kushteve minimale teknike, sanitare-higjienike dhe të tjera të lokaleve dhe bizneseve janë inkasuar në gjoba dhe pranime teknike dhe asgjësime në vlerë prej 2670 euro. Me nismën e këtij organi dhe në bashkëveprim me inspektorët sanitar të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës të Kosovës, është kontrolluar aspekti i përgjithshëm, kushtet sanitaro-higjienike të subjekteve të ndryshme afariste. Janë marrur strishot e të punësuarve dhe nga mjetet e punës së tyre. Po ashtu, ka marrë pjesë në shumë komisione komunale, si menaxhim të kontratës për trajtim të qenve endacak si dhe pjesëmarrje në trajnime, seminare të nivelit qendror, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta.

### ***Inspektimi në lëminë e tregut***

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, kualiteti i produkteve industriale dhe ushqimore, cilësia e shërbimeve, verifikimi i regjistrimit /pajisja me certifikata për regjistrimin e biznesit/ të të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve tjera, ka qenë objektiv i punës dhe aktivitetit të këtij organi e që ka ushtruar 160 kontrole inspektuese me ç'rast ka udhëhequr procesverbale mbi faktimin e gjendjes në vend duke proceduar me nxjerrjen e 45 aktvendimeve përmbajtjesore për eliminimin e të metave të konstatuara, duke i vu afatet dhe duke ushtruar kontrole kthyes inspektuese për përmbushjen dhe përmbarimin e të njëjtëve, atë për paralajmërim për mbyllje-ndërprerje të aktivitetit biznesor.

Duke koordinuar me inspektorin sanitar është ushtruar kontrolli inspektues ndaj furrave të bukës për 5 raste kurse është ndërmarre masa administrative për gatim të standardizuar me etiketë të deklaruar që përmban peshën e bukës, adresën e prodhuesit, përbërjen-shtesat/aditivet/, datën e prodhimit, afatin dhe mënyrën e përdorimit dhe çmimin e shitjes sipas njërive të destinuara për shitje në treg si dhe 60 raste pjesëmarrjes në komisionin vlerësues për kushtet minimale teknike, higjieno-sanitare dhe të tjera të lokalit duke nxjerrë kështu 60 aktvendime për dhënien e pelqimëve gjegjëse, ku janë inkasuar në emër të shpenzimeve komisionare inspektuse për këtë qëllim 1199 euro. Në mbikëqyrjen e rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste shënohen 25 mbikëqyrje dhe atë më shumë gjatë orëve të vona të natës. Janë hartuar 15 informata, raporte, shënime zyrtare, sqarime dhe interpretimeve procedurave në vijën horizontale dhe vertikale.



Në pasqyrimin e punëve dhe aktiviteteve punuese për vitin raportues nuk është përfshirë puna qoftë vetanake qoftë në bashkëveprim me inspektoret e tregut në kuadër të MTI-së sipas planit të veprimit të inspektoratit të tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës.

Në zbatim të Ligji nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Kosovës, në mbështetje të nenit 65 të kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me inspektorin sanitar kemi ushtruar mbi 400 mbikëqyrje inspektuese dhe kemi përpiluar 325 procesverbale mbi konstatimin e gjendjes, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe me inspektorët përgjegjës janë marrë masa ndëshkuese dhe vërejtje me shkrim.

#### ***Inspektimi nga lëmi financiar-lejeve të punës/regjistrimit/ të bizneseve***

Në këtë lëmi janë ushtruar 131 mbikëqyrje inspektuese, kurse lidhur me to janë hartuar 115 procesverbale për konstatimin e gjendjes në vend. Janë nxjerrë 16 aktvendime të komisionit për përcaktimin e kushteve minimale teknike-higjiëno-sanitare si dhe për dënime mandatore në shumën prej 1.006 euro dhe të tjera të lokalit për biznese ku janë plotësuar urdhërpagesat për kompensim të pagesave në emër të taksës. Po ashtu, është bashkëvepruar me inspektorët tjerë në nivel të drejtorisë në aksionet e koordinuara të përbashkëta dhe në monitorimin e tregjeve.



## DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Drejtoria E Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillim Rural duke u bazuar në pozitën e përshtatshme gjeografike dhe kushteve të volitshme klimatike që i ka territori i komunës së Klinës për kultivimin e kulturave bujqësore, të perimtarisë, pemëtarisë dhe zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë, gjatë vitit 2021, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të këtyre kulturave, përmes subvencioneve të ndryshme i ka përkrahur fermerët e komunës sonë.

Që prodhimet agrobujqësore dhe të hyrat nga prodhimtaria e kulturave bujqësore të rriten për fermerët, përmes eksperteve të saj gjatë gjithë vitit, atyre ju ka dhënë këshilla profesionale. Me qëllim të mbështetjes së fermerëve dhe mbrojtjes së pyllit, gjatë vitit 2021 ka bashkëpunuar me organizatën humanitare "Islamic Relief Kosova", me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Agjencinë Pyjore të Kosovës.

### *Spektori i bujqësisë gjatë vitit 2021 ka zhvilluar aktivitete si në vijim:*

- Ka pranuar dhe shqyrtuar kërkesat dhe ankesat e ndryshme të parashtruara nga fermerët dhe qytetaret;
- ka përgatitur planin për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore në territorin e komunës së Klinës;
- me qëllim të monitorimit të mbjellave vjeshtore dhe pranverore dhe të kultivimit të pemëve, perimeve, blegtorisë dhe bletarisë, ka vizituar kohë pas kohe fermerët;
- që fermerët të jenë sa më të informuar, lidhur me aktivitet nga lëmia e blegtorisë, lavërtarisë, pemëtarisë, perimtarisë, bletarisë etj., ka organizuar trajnime profesionale online;
- ka përgatitur planin për korrje-shirjeve dhe ka përcjellje korrje-shirjeve në teren të grurit, elbit dhe tërshërës, si dhe ka monitoruar gjendjen teknike të autokombajnave që kanë zhvilluar aktivitetin e korrje-shirjeve në territorin e komunës së Klinës;
- gjatë vitit 2021, në territorin e komunës së Klinës janë mbjellë katërmijepesëqindetridhjetë (4530) hektar grurë, njëqindeshtatëdhjetë (170) hektar elb, njëqindnjëzetepesë (125) thekër dhe katërqindnjëzetepesë (425) foragjere;
- ka informuar fermerët, rreth grandeve dhe subvencioneve që jepen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia për Zhvillim e Bujqësisë;



- ka pranuar gjashtëqindeshtatëdhjetë (670) aplikacionet nga fermerët për subvencionimin e pagesës direkte për sipërfaqet e mbjella me grurë, misër, tërshërë, elb, pemë, perime, bletë, bagëti (lopë, dele, dhive, dosa etj.), cilësi të qumështit;
- ka ndërtuar dyqindnjëzetepesë (225) metra kanal për ujtiqe në fshatin Stupë dhe njëmijnjëzetedy (1022) metra në fshatin Dollovë;
- ka filluar më ndërtimin e kanaleve për ujtiqe në fshatrat Grabanicë, Krushevë e Madhe;
- ka filluar me shtrimin e rrugëve fushore me zhavorr;
- në bashkëpunim me organizatën humanitare “Islamic Relief Kosova” ka hapur dyzetetë (48) puse për fermerët, me gjithsej njëmijekatërqindeshtatëdhjetedy (1472) metra;
- ka kryer edhe aktivitete të tjera, sipas urdhrit të drejtorit të drejtorisë.

***Sektori i pylltarisë gjatë vitit 2021 ka zhvilluar aktivitetet si në vijim:***

- në vazhdimësi ka monitoruar gjendjen e pyjeve në të gjitha rajonet ekonomike pyjore që janë në pronësi shoqërore dhe mbrohen si kompetencë e deleguar nga komuna e Klinës;
- ka bërë evidentimin e pyjeve dhe tokave pyjore të uzurpuara në territorin e komunës së Klinës, të cilat mbrohen si kompetencë e deleguar nga niveli qendror. Ka konstatuar së pyjet dhe tokat pyjore janë uzurpator në pesë zona kadastrale, pra në zonat kadastrale: Perqevë, Gllarevë, Volljakë, Sferkë dhe Qupevë nga dyzetekatër (44) persona fizik në njëzetentë (29) ngastra të ndryshme.
- ka bërë regjistrimin e dëmit pyjor të shkaktuar nga dëmtuesit e pyllit gjatë vitit 2021. Ka konstatuar dëmin total të shkaktuar gjatë vitit 2021. Dëmi total i shkaktuar është 81.64 m<sup>3</sup>, i arsyetuar me fletëparaqitje është 34.28 m<sup>3</sup>, ndërsa i pa arsyetuar është 47.36 m<sup>3</sup>.
- ka ushtruar njëzetënjë (21) fletëparaqitjeve në gjykatën themelore Pejë–dega Klinë, divizionin për kundërvajtje, kundër dëmtuesve të pyllit dhe një (1) kallëzim penal në prokurorin themelore në Pejë;
- ka përgatitur dhe ushtruar njëzetënjë (21) ankesa në gjykatën e apelit në Prishtinë, kundër aktgjykimeve të shkalles së parë të gjykatës themelore Pejë – dega Klinë;
- ka përgatitur dhe dorëzuar në Gjykatën Themelore Pejë – dega Klinë njëzeteshtatë parashtrës, njëzetënjë për plotësimin e fletëparaqitjes së ushtruar nga rojet e pyllit, katër për informim lidhur me ecurinë e procedurës gjyqësore, një për sjelljen me forcë të dëshmitareve më dhënë dëshminë dhe një për përshpejtim të zgjedhjes së fletëparaqitjeve të ushtruara nga drejtoria e bujqësisë;



- ka pranuar gjashtëdhjetegjashtë (66) aktgjykime dënuese nga Gjykata Themelore Pejë – dega Klinë dhe tetëmbëdhjetë (18) aktgjykime nga gjykata e apelit. vlera e gjobave të shqiptuara është 17,700.- €;
- ka pranuar dymbëdhjetë (12) aktvendime nga Gjykata Themelore Pejë – dega Klinë dhe prokuroria themelore në Pejë. shtatë (7) për hedhje poshtë të fletëparaqitjeve (për shkak të mangës së të dhënave personale) dhe tre (3) për pezullim të procedurës gjyqësore (për shkak së fletëparaqitjet janë ushtruar kundër personave të gabuar);
- ka përfaqësuar drejtorin e bujqësisë në shtatëdhjetë (70) seanca gjyqësore, në procedurën kundërvajtës dhe penale;
- ka sekuestruar 2.47 m<sup>3</sup> masë drusore, të prerë në pronën shoqërore;
- përmes ankandit publik ka shitur në vlerë prej 650. -€, njëzetekatër pikë katërmëdhjetë (24.14) m<sup>3</sup> dru të konfiskuara gjatë vitit 2020;
- ka shqyrtuar tri (3) kërkesa të parashtruara nga qytetaret për damkimin e masës drunore në pyjet private dhe ka lëshuar gjashtë (6) fletë përcjellje për transportim të masës drunore të prerë në pyjet private dhe nëntë (9) fletë përcjellje për transportimin e masës drusore të shitura përmes ankandit publik;
- në baza mujore ka përgatitur dhe dërguar raportet mujore, lidhur me aktivitet e ndërmarra në pyll, në drejtorin koordinuese të APK-së në Pejë;
- ka përgatitur raportet dhe planet mujore të punës, ato vjetore si dhe planin për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri;
- ka kryer edhe aktivitete të tjera, sipas urdhrit të drejtorit të drejtorisë.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

### **ARKIVI HISTORIK I KLINËS**

Në Arkivin Historik të Klinës është punuar në vazhdimësi dhe në mënyrë sistematike në mbledhjen, grumbullimin dhe sistemimin e lëndës arkivore brenda territorit të komunës së Klinës. Arkivi Historik i Klinës posedon 35 fonde, me gjithsej 165 metra gjatësi lëndë arkivore. Për shkak të pandemisë COVID-19 dhe mungesës së stafit, puna në rregullimin e lëndës arkivore ka stagnuar, por me kompletimin e stafit mbetet të rregullohen gjatë vitit 2022. Gjithashtu është filluar me punë në digjitalizimin e disa lëndëve arkivore me prioritet.

#### **Lëndët e digjitalizuar:**

<b>Emri i fondit</b>	<b>Vitet</b>	<b>Kuti</b>	<b>Dosjet</b>	<b>Faqe</b>
Fondi i UÇK-së	1997-1999	1	1-5	702
Drejtorja e Arsimit Klinë	2000	1	1-3	182
Bashkësia e Sigurimit Pensional dhe Invalidor e Klinës	1966-1998	1	1938	235

#### **Lëndët e marra me procesverbal**

<b>Procesverbali nr.</b>	<b>Fondkrijuesi</b>	<b>Vitet</b>	<b>Gjatësia në metra</b>
02.03.2021	Sekretariati i Punëve të Brendshme dega në Klinë	1990-1999	15 m
06/2021 28.07.2021	SHFMU „Nënë Tereza” Budisalc	1956-1990	10 metra
09/2021 06.12.2021	Biblioteka e qytetit „Kongresi i Manastirit” në Klinë	1968-2008	1.50 metra

Krahas punës në marrjen dhe rregullimin e lëndës arkivore, prioritet për arkivin ka qenë puna me palë, pranimi i kërkesave dhe shqyrtimi i tyre. Gjatë vitit 2021 janë pranuar dhe shqyrtuar 95 kërkesa për dokumentacion të ndryshëm që posedon arkivi, qoftë për çështje hulumtimi, lëshimin dhe vërtetimi i kopjeve dhe pajisjes me dokumentacion për qytetarët.

#### **Numri i kërkesave**

<b>Kërkesa të pranuar</b>	<b>Të realizuara</b>	<b>Të parealizuara për shkak të mungesë së lëndës arkivore</b>	<b>Kopje A3 të vërtetuara</b>	<b>Kopje A4 të vërtetuara</b>
95	67	28	159	104



## ➤ **BIBLIOTEKA E QYTETIT “KONGRESI I MANASTIRIT”**

Biblioteka e qytetit “Kongresi i Manastirit” në Klinë, nga planifikimi i punës për vitin 2021 ka arritur rritjen e fondit librar, mirëmbajtjen e fondit të librave, përpunimin e librit, përmirësimin e fondit librar në bazë të kërkesave të lexuesve, spastrimin dhe ruajtjen e koleksioneve të veçanta. Këtë vit biblioteka është pasuruar në fondin e saj me një numër të titujve të rinj dhe ripërtëritjen e titujve ekzistues.

-Grandet dhe donacionet e fituar gjatë vitit 2021 për bibliotekën e qytetit:

-Donacion me tituj të ndryshme të romaneve;

-Grand i fituar nga MKRS, vlera 3000.00 euro;

-Komuna e Klinë, vlera 2000,00

-Të gjitha këto shprehur në numra gjatë këtij viti kalendarik janë 1641 ekzemplarë apo 722 tituj.

Statistikat e lexuesve gjatë 2021: 355 lexues të rregullt, që në total për 1 vit pune janë furnizuar me 1 800 romane.

## ➤ **SEKTORI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

Për shkak të situatës pandemike nga COVID-19 janë anuluar shumë aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive që organizohen në kuadër të DKRS-së.

Aktivitetet e mbajtura përfshijnë:

- Manifestimin kulturor- ekspozita figurative tradicionale “Art Klina” edicioni i gjashtë.

-Promovimi i librit me tri vëllime “Gjenocidi serbo-malazes dhe pushtimi i trojeve shqiptare 1800- 1999 “me autor Rrustem Berisha, mbajtur në kuvendin e komunës së Klinës.

- Manifestimi tradicional letrar “Ora e Tahir Deskut” edicioni i 12-të.

Gjithashtu zhvilluan aktivitet të tyre edhe OJQ- të, që janë mbështetur nga DKRS:

-Më 30, 31 korrik u mbajt “UJËVARA FEST” edicioni i pestë, në Ujëvarë të Mirushës i organizuar nga SHK-Jehona e Dukagjinit-Klinë.

-Me 16,17, 18 gusht u mbajt “CAMPING FEST” edicioni i tretë në Dresnik, i organizuar nga ArtEko.

-Sa i përket investimeve, është investuar në krijimin e kushteve më të mira të punës në arkivin historik si dhe në qendrën kulturore Jehona e Dukagjinit.

- Në sektorin e rinisë janë zhvilluar disa aktivitete rinore në bashkëpunim me OJQ të cilat veprojnë në komunën e Klinës dhe janë mbështetur nga DKRS.

Gjithashtu edhe sektorin e sportit, aktivitetet e shumta kanë qenë të pezulluara duke bërë kështu që mos të mbahen turnire dhe gara tradicionale.

Megjithatë janë mbështetur klubet sportive në mbarëvajtjen e garave sipas kalendarit të garave në federatat përgjegjëse. Janë subvencionuar të gjitha klubet sportive që përfaqësojnë komunën e Klinës.

Gjithashtu janë bërë investime kapitale kryesisht në ndërtimin e fushave sportive në parkun "Ilir R. Merturi", që ofrojnë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve si:

- Fusha ndihmëse në futboll;
- Fusha e tenisit;
- Fusha e volejbollit;
- Fusha e basketbollit;
- Tavolina të ping-pongut;
- Gjimnastikë.

➤ ***Përgjegjësi për zërim, ndriçim dhe kinoaparatur***

-Është siguruar zërimi për aktivitetin në ShFMU „Motrat Qiriazi” në Klinë si dhe paralelen e ndarë në Zajm, me rastin e programit festës së abetares.

-Përgatitja e sallës për tubimet politike të mbajtura gjatë fushatës zgjedhore.

-Organizimi i turnirit memorial për nder të dëshmorëve Sylë, Idriz dhe Milazim Balaj, në bashkëpunim me Federatën e Boksit të Kosovës.

-Aktivitete të zhvilluara me Kuvendin e të Rinjve të Kosovës, me rastin e konferencës për punime shkencore.

-Me kërkesë të OJQ “Zana” kemi organizuar debatin me qytetarët dhe kandidatët për kryetar komune gjatë fushatës zgjedhore.

- Me rastin e festave të nëntorit është organizuar aktiviteti tradicional “Art Klina”.



-Organizimi dhe rregullimi i sistemit të zërimit dhe ndriçimit në sallën e kulturës, me rastin e shfaqjes “Hajde në shkollë” organizuar në bashkëpunim me “Up To Youth”.

- Organizim me rastin e manifestimit kulturor “Ora e Tahir Deskut”.

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë gjatë vitit 2021 është angazhuar në realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Gjatë periudhës vjetore 2021, në sektorin e shërbimeve publike nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej 536 kërkesa, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me riparimin e rrugëve me zhavorr në fshatra dhe disa rrugica nëpër lagje të qytetit, riparim të gropave në rrugët me asfalt, furnizim me ujë dhe riparim të ujësjellësit, riparim dhe kycje në kanalizim, pastrimin e rrugëve nga bora, leje për shfrytëzim të hapësirës publike, kërkesa për ndriçimin publik si dhe kërkesa për ndihmë me artikuj ushqimor dhe materialit ndërtimor për ndërtim apo rinovim të shtëpive. Varësisht nga mundësitë buxhetore jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

❖ Të miratuara .....	365
❖ Të refuzuara .....	19
❖ Në proces .....	142
❖ Të pranuar .....	5
❖ Të pezulluar .....	2
❖ Të anuluar .....	3
❖ Te hedhura poshtë .....	0
Gjithsej.....	536 kërkesa

Ndërsa, sa i përket projekteve të realizuara dhe në realizim e sipër për këtë vit shkurtimisht po i theksojmë disa prej rezultateve të arritura për vitin 2021:

- **Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit.** Komuna nga buxheti i saj harxhojë vetëm 9,999.99euro,
- **Rregullimi i varrezave të veteraneve:** Edhe në vitin 2021 komuna Klinës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë rregullimin dhe përmirësimin e gjendjes së varrezave të veteranëve të Klinës. Vlera e kontratës ka qenë 6,975.00€.
- **Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve pa asfalt.** Në vazhdimësi kemi kërkesa të shumta në bazë ditore lidhur me riparimin e rrugëve ende të pa asfaltuara në të gjitha fshatrat dhe brenda në qytet. Deri më tani kemi intervenuar në sanimin e gropave, rrafshimin, mbushjen dhe ngjeshjen me cilindër në rrugë e rrugica në fshatra dhe periferi të qytetit. Kemi shpërndarë rreth 13,400m<sup>3</sup> zhavorr të fraksioneve të ndryshme për meremetimin e rrugëve lokale, ndërsa për heqjen e mbeturinave inerte kemi përdorur ekskavator të llojeve të ndryshme me 196 ore punë. Buxheti i harxhuar për këto punë dhe furnizime ka qenë rreth 79,891.84 euro.
- **Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt.** Në vitin 2021 komuna e Klinës kishte kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve me asfalt, ku ka punuar në shumë fshatra dhe në lagje të Klinës. Mirëmbajtja e rrugëve me asfalt kishte intervenime gjithsej 3791m<sup>3</sup>.
- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik.** Në vitin 2021 komuna Klinës ka zgjeruar rrjetin e saj në shumicën e fshatrave të Klinës. Si në fshatin (Gillarevë, Ujmirë, Budisalc, Deiq, Zabergj, Zajm, Dollovë, Volljakë, Sferkë, Pjetërq, Grabanicë, Shtupel dhe fshatra tjera. Investim ka pasur edhe në lagjet e qytetit, si në lagjen Arbëria, Dukagjini, lagjen e spitalit dhe qendrën e qytetit. Përveç që ka pasur zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik, ka pasur vazhdimisht edhe mirëmbajtje të dritave si dhe janë



zëvendësuar edhe shtyllat prej drurit të cilat kanë qenë në gjendje të keqe dhe janë zëvendësuar me shtylla të betonit prej 9m lartësi.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i kamerave të qytetit.** Sipas planifikimit është bërë zhvendosja e kablllove optike në qendër të qytetit, respektivisht në sheshin “Mujë Krasniqi” nga shtyllat dhe objektet tjera, në galerinë nëntokësore dhe rivendosja e kamerave në shtylla të reja apo objekte të përsishmë për vëzhgimin e qytetit.
- **Mirëmbajtja e drunjve dekorativ.** Në qytet kemi rreth 400 trupa të drunjve dekorativ. Rreth 300 trupa janë duke filluar nga sheshi “Ndue Përllëshi”, sheshi “Mujë Krasniqi”, sheshi “Nena Terezë” e deri te sheshi “Faruk Elezi”. Duke qenë se për 3 vite rresht kjo pjesë e qytetit ishte në ndërtim për shkak të punimeve të tunelit dhe kalldrëmit, drunjtë kishin pësuar dëmtime të mëdha, prandaj është dashur që në mënyrë profesionale të trajtohen, duke filluar nga krasitja, plehërimi, trajtimi me insekticide, instalimi i sistemit të ujitjes, punimit të tokës përreth etj. Tani pemët kanë marrë formë të mirë dhe të njëtrajshme. Kanë rritje të mirë dhe janë të shëndetshme.
- **Mirëmbajtja dhe zgjerimi i hapësirave publike/ Parqe dhe parking për automjete/.** Gjithashtu edhe në këtë vit është vazhduar me përmirësimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve ekzistuese, posaçërisht shëtitoretja përgjatë lumit Klina, duke vazhduar me trendin e zgjerimit të këtyre hapësirave publike. Në vitin 2021 është shndërruar një deponi e mbeturinave rreth 400m<sup>2</sup> në qytetin e Klinës në hapësirë publike, duke shndërruar pamjen tërësisht dhe duke mundësuar shfrytëzimin veturave për banorët e kësaj lagje.
- **Renovimi i kulmeve të banesave.**  
(P+4 NR.00511-3-62-0) (P+4 NR.00516-1-8-0) (P+4 NR.00414-1-35-0) (P+4 NR.00516-1-8-0) (P+4 NR.00585-2-45-0). Këto banesa ju janë rinovuar kulmet me llamarine, duke përmirësuar jetën e banorëve të këtyre ndërtesave, ku prej vitesh kishin pësuar dëmtime të kulmit dhe iu ishte vështirësuar jeta nga reshjet e bores dhe shiut.
- **Rregullimi i shtretërve të lumenjve.**  
Është bërë edhe pastrimi i lumenjve, ku prej vitesh bëhet hedhja e mbeturinave dhe derdhja e shumë kanalizimeve. Ne kemi bërë edhe pastrimin e lumenjve dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve. Me rreth 74,700€ kontrata për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe rreth 6000.00€ për pastrimin e shtretërve të lumenjve dhe mbrojtjen e shtretërve me gurë natyral.
- **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në qytet dhe fshatra.**  
Sipas Planit Operativ territori i komunës së Klinës është ndarë në tri pjesë. Operatori i përzgjedhur ka siguruar sasinë e mjaftueshme të kripës dhe rërës për akull, ndërsa makineria është në gatishmëri sipas kërkesave dhe kushteve të parapara me kontratë. Kemi inspektuar gatishmërinë në vendet e caktuara dhe kemi intervenuar në muajin shkurt dhe mars 2021.
- **Mirëmbajtja dhe riparimi i rrjetit të kanalizimeve.** Rrjeti i kanalizimeve në shumë fshatra dhe qytet po paraqet problem të madh në mirëmbajtje. Hedhja e mbeturinave në puseta dhe kyçja e stallave të bagëtive apo ujërave të shiut shpesh shkakton defekte shumë të mëdha. Problemi më i madh paraqitet në pjesët ku është instaluar kanalizimi, mirëpo nuk ka ende rrjet të ujësjellësit dhe si pasojë KRU HIDRODRINI nuk e merr në mbikëqyrje për shkak se nuk e vjelë tarifën e ujit të shpenzuar. Ne kemi intervenuar në fshatrat Caravik, Gllarevë, Sferkë, Gremnikë dhe Gjurgjevik i Madh.
- **Trajtimi i qenve endacak.** Qentë endacak janë problem i gjithë Kosovës. Komuna e Klinës është ndër komunat e pakta të Kosovës që kanë lidhur kontratë për trajtimin e



genve endacak. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente kishe lidhur kontratë me shumën 20,000€, ku në këtë kontratë ne kemi trajtuar, sterilizuar, shëruar, larguar dhe ushqyer qentë endacak. Është bërë kastrimi i tyre dhe janë mbajtur dhe ushqyer e mbikëqyrur deri në shërimin e plotë të tyre pastaj ata përsëri janë lëshuar në vendin ku janë kapur. Atyre iu ka kaluar tërbimi dhe rreziku nga ta.

- **Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me energji elektrike.** Me kompaninë për mirëmbajtjen e rrjetit dhe furnizim me energji-KEDS kemi kontakte të rregullta javore në nivele të drejtorisë dhe Nj.O në Klinë, ndërsa mujore me zyrën e kryetarit dhe Zyrën Regjionale në Pejë. Jemi dakorduar që të bëjmë punë të përbashkëta në përmirësimin e rrjetit elektrik në fshatra, ndërrimin e shtyllave dhe instalimin e kablllove. Kemi kërkesa të shumta nga qytetarët e pothuajse të gjitha fshatrave, mirëpo duke marrë parasysh që KEDS është ndërmarrje e privatizuar për 99 vite, ndikimi ynë është shumë i kufizuar.

### ***Njësia Profesionale e Zjarrfikëseve për shpëtim***

NJPZSH në Klinë gjatë kësaj periudhe kohore aktivitetin e vetë e ka bazuar në planin e punës për vitin 2021 dhe si zakonisht ka arritur t'i përmbush me sukses objektivat e parapara me plan.

NJPZSJ-it ka vazhduar ta mbaj nivelin e gatishmërisë për reagime në rast nevojë edhe për raste emergjente për periudhën e lartcekur.

Ne jemi angazhuar që shërbimet tona të jenë në nivel të përgjegjshisë dhe detyres që na obligojnë ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës.

NJPZSH-it është përgjigjur rasteve sipas obligimeve në përputhshmeri me kapacitetet tona ekzistuese si dhe jemi përgjigjur me kohë kërkesave të qytetarëve të dëmtuar. Nga NJPZH-it në Klinë gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 272 dalje, 183 raste zjarri dhe 89 intervenime teknike.

Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH-it gjatë periudhës janar-dhjetor janë paraqitur në tabelarin që pason:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve dhe struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera për janar-dhjetor 2021.

### **Viti 2021- Komuna Klinë- Realizimi i numrit të përgjithshëm të intervenimeve pr muajin janar-dhjetor 2021**

Nr. i përgjigjur i daljeve	Nr. I zjarreve	Shërbime	Aksidente rrugore	Vërshime	Te rrejshme	Te ndryshme	Te lënduar
272	183	19	10	24	0	36	0

### **VITI 2021-STRUKTURA E ZJARREVE**

Objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura	Zjarre në automjete	Pajisje elektrike	Të tjera
11	108	5	13	46



## DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

### **Fushëveprimtaria:**

Bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtorja ka këtë fushëveprim:

- mbikëqyrja e punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare /QKMF/, Qendrës së Mjekësisë Familjare /QMF/, Ambulancës së Mjekësisë Familjare /AMF/ dhe Qendrës për Punë Sociale /QPS/.
- hartimi i strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor që përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, edukimin shëndetësor, imunizimin, diagnostifikimin e parë dhe kujdesin themelor shëndetësor, promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit themelor stomatologjik
- vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare
- koordinon dhe mbikëqyr punën e Qendrës për Punë Sociale dhe përmes saj siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës së Klinës, sipas standardeve të specifikuara nga ministria përkatëse
- përmes QPS siguron implementimin e plotë të infrastrukturës ligjore që rregullon përkujdesjen e rasteve sociale të popullatës së komunës, përmes shpërndarjes së drejtë të ndihmës sociale
- mbikëqyrjes së situatës epidemiologjike në nivel të komunës
- të zhvillojë buxhetin bazuar në nevojat lokale duke iu përmbajtur udhëzimeve nga MSh dhe Kuvendi komunal i Klinës
- vendos dhe mbledh bashkë-pagesat, liron kategoritë e caktuara të shoqërisë brenda kornizës së caktuar nga MSh dhe Kuvendi komunal
- siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës
- raporton mbi të arriturat e objektivave të përcaktuara, Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës
- zhvillimi, monitorimi dhe zbatimi i rregulloreve ekzistuese që i lëshon MSh dhe kuvendi komunal
- zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore të aprovuara nga MSH dhe Kuvendi i Komunës
- bashkëpunon me MSH, vendos dhe zbaton politikat e mbrojtjes së kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha kategoritë tjera të fëmijëve, përmes QPS, në nivelin lokal
- përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët
- ushtron edhe kompetencat tjera që dalin nga ligjet e veçanta, statut të komunës, akte nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;



## **QKMF / QMF / AMF – Raport i punës**

Objektivi kryesor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, përgjatë vitit 2021, ka qenë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët, me fokus në gjendjen pandemike Covid 19.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë rritja e numrit të shërbimeve mjekësore të ofruara në QKMF, është përmirësuar furnizimi me medikamente për pacientët, janë përmirësuar shërbimet e patronazhes, kujdesit paliativ, etj.

Në veçanti, fokusi kryesor edhe gjatë vitit 2021 ka qenë lufta kundër pandemisë globale Covid 19, e cila përgjatë vitit 2021, në faza të ndryshme kohore ka shënuar rritje të dukshme të rasteve të infektuara, duke kërkuar edhe mobilizim shtesë të stafit mjekësor në mënyrë që të përballohet më lehtë dhe me pasoja sa më të vogla.

Testimet për Covid 19, kryesisht me teste rapid, janë bërë përgjatë gjithë vitit 2021. Vëmendje e madhe i është kushtuar rritjes së imunizimit me anë të vaksinimit kundër Covid 19.

Furnizimet mjekësore /barna dhe paisje mjekësore/ janë bërë me kohë dhe në sasi të mjaftueshme falë investimeve nga Komuna e Klinës si dhe nga Lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë. Qytetarët tanë kanë marrë shërbime cilësore në QKMF dhe janë furnizuar në masë të madhe me ilaçet kundër Covid 19 por edhe kundër sëmundjeve tjera.

Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikë - Edhe në shërbimin e diagnostikës në QKMF janë kryer numër i madh i shërbimeve cilësore, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit, me aparatura moderne dhe pa kosto për shumicën e qytetarëve.

Ndonëse të kufizuar në masë të madhe për shkak të pandemisë Covid 19, nuk kanë munguar edhe investimet kapitale në QKMF e AMF, duke përmirësuar dukshëm kushtet e punës dhe frimin e shërbimeve profesionale për qytetarët e komunës sonë. Janë krijuar hapësira të reja dhe është bërë renovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore.

Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore ka qenë prioritet edhe përgjatë vitit 2021. Është bërë trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante.

Ka vazhduar bashkëpunimi me donatorët ekzistues dhe janë zhvilluar takimet e reja me donatorët potencial ku janë prezantuar objektivat tona parësore dhe projektet e planifikuara.

Vëmendje e madhe i është kushtuar programit për kujdesin mjekësor për të moshuarit, kujdesit paliativ dhe pacientëve terminal si dhe kujdesit mjekësor për komunitetet pakicë. Është bërë ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk kanë mundur të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF.

Gjatë kësaj periudhe, në të gjitha shërbimet, personeli shëndetësor ka respektuar masat mbrojtëse sipas urdhëresës së MSh dhe IKShP-së. Furnizimi me masa mbrojtëse ka qenë në nivel dhe dezinfektimi i objektit të QKMF-së është bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt.

Sfidë ka qenë funksionalizimi i plotë i Sistemit Informatik Shëndetësor.

Në periudhen deri më 31 dhjetor 2021, janë dhënë:

34953 doza të vaksinës kundër Covid 19.

Doza të para - 18350.

Doza të dyta - 16274.



Doza të treta - 229.

Janë bërë 19500 teste për Covid-19, prej tyre kanë rezultuar pozitiv 3000 qytetarë.

Janë dhënë 1701 vaksina kundër gripit sezonal.

Numri i pacientëve me insulinë ka qenë 229, prej tyre 7 janë fëmijë.

Numri i pacientëve me dializë -14.

Të pickuar nga rriqërat kanë qenë 141 raste.

Gjatë vitit 2021 kemi pasur:


Të aksidentuar – 223 qytetarë

Raste të vdekjes - 14 qytetarë

Janë bërë 20 vizita psikologjike.

Më poshtë gjeni tabelat me përmbledhje dhe grafikat


Përmbledhje Shërbimet	Vizitat	Participimi	Udhezimet		
			Brendshëm	Dytësor	Terciar
Mjekësia Familiare	63363	9387	1437	729	308
Pediatria	2554	0	83	25	36
Gjinekologjia	1599	420	47	0	17
Stomatologjia	1441,0	165,1	39	1	0
Specialistika	18965	8871	1310	662	360
<b>Totali</b>	<b>87922</b>	<b>18 842,55 €</b>	<b>2916</b>	<b>1417</b>	<b>721</b>







Kategoria	Sherbimet
Barnatorja	7739
Echo	890
Ekg	1451
Inekcione	37773
Infuzione	24154
Inhalime	1107
Laboratori	12546
Lidhje	7193
Qepje	98
Rentgeni	8164
Vaksinimi	7755
Terreni	4905
<b>Totali</b>	<b>113775</b>



Qendra për Punë Sociale – Raport i punës



Qendra për Punë Sociale në bazë të fushë veprimtarisë së vet ka bërë përpjekje për kryerjen e misionit të saj në mënyrën më të mirë duke u mbështetur në detyrat dhe obligimet që i posedon në raport me ofrimin e shërbimeve për qytetarët pa dallim. Po ashtu kujdes i veçantë i është kushtuar implementimit të politikave që janë nxjerrë nga niveli qeveritar në implementimin e standardeve për mbrojtën e kategorive të ndryshme sociale që kanë nevojë për këto shërbime.

Në kuadër të misionit të QPS-së, tretman i veçantë i është kushtuar kategorive më të rrezikuara dhe që kanë nevojë për shërbimet që ju ofron ky institucion në veçanti për këto kategori: Fëmijët e braktisur, fëmijët pa kujdes prindëror, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, personat e moshuar dhe pa përkujdesje, personat më nevoja të veçanta, delikuentet etj.

Mision tjetër i QPS-së ka qenë edhe ofrimi i ndihmës financiare nëpërmjet sektorit të Asistencës Sociale për familjet nevojtare të cilat i plotësojnë kriteret që janë të parapara në Ligjin dhe Udhëzimet Administrative në fuqi, gjithmonë duke u bazuar edhe në verifikimin dhe monitorimin e këtyre familjeve nevojtare.

### **Fusha e trajnimit**

Gjatë vitit 2021, stafi i Qendrës Për Punë Sociale, ka marrë pjesë në disa trajnime kryesisht të fushës sociale. Për shkak të gjendjes pandemike në vend, shumica e trajnimeve janë mbajtur përmes platformës online.

### **Bashkëpunimi më Organizatat jo qeveritare**

Kur jemi të bashkëpunimi më Organizatat Jo Qeveritare, ne si Institucion kemi pasur një bashkëpunim mjaft të mirë më të gjitha ato Organizata që për mision kanë mirëqenien e qytetarëve, andaj unë do ti veçoja disa nga këto:

- OJQ "Arbeiter Samariter Bund- ASB" me seli në Prizren ku është realizuar suksesshëm projekti "Mbështetje e Integruar Socio ekonomike për familjet e prekura pakicë dhe shumicë në Klinë". Më anë të këtij projekti janë mbështetur 10 familje shfrytëzuese të asistencës sociale për krijimin e kushteve më të mira të jetesës dhe themelimin e bizneseve të vogla familjare. Ky projekt është realizuar në bashkëfinancim më Komunën e Klinës.
- Caritas Umbria - e cila çdo herë na përgjigjët në kërkesat tona për ndihmë familjeve skamnore;
- Qendra për Mirëqenien e Gruas - Shtëpia e Sigurt në Pejë, ku kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë, ku çdo herë na janë përgjigjur pozitivisht në kërkesat tona për strehimin e viktimave të dhunës në familje, duke respektuar kështu memorandum bashkëpunimin e kësaj Organizate me Komunën e Klinës.
- Terre des hommes, Organizatë kjo që përpos trajnimeve të organizuara, herë pas here na ka ndihmuar në ofrimin e ndihmës direkte (veshmbathje, pajisje shkollore, medikamente mjekësore) për disa familje.



- Shoqata Humanitare Bamirëse "Dushkaja", me seli në Gjakovë, ku janë ndihmuar shumë familje skamnore me veshmbathje të përdorura, të ardhura nga Gjermania.
- UNICEF - United National International Children's Emergency Fund (Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet).
- OFAP - Organizata për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror
- GIZ – Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Save the Children në Kosovë, pastaj bashkëpunim të mire kemi pasur edhe me OSBE, Syri Vision - Organizatë që realizon veprime lokale të bazuara në praktikat më të mira me seli në Pejë, etj.

### Pjesa kryesore

Raporti është përpiluar i ndarë sipas sektorëve që funksionojnë në kuadër të QPS-së, atë të Shërbimeve Sociale dhe Familjare dhe Sektorin e Asistencës Sociale.

### Sektori i Shërbimeve Sociale

Sektori i Shërbimeve Sociale gjatë vitit 2021, ka kryer 748 shërbime, në këto shërbime përfshihen nga këshillimi deri të përkrahja për familjet me probleme familjare, kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve, kujdesi dhe mbrojtja e të moshuarve, si dhe shërbime tjera shtesë administrative (vërtetime, deklarata të ndryshme dhe shkresa tjera).

Bashkëpunimi i Sektorit të Shërbimeve Sociale më Institucione si, Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, Institucionet shkollore, zyrën për ndihmë juridike falas, mbrojtësen e viktimave, si dhe me OJQ të ndryshme ka qenë në nivelin më të mirë të mundshëm.

Gjatë vitit 2021, Shërbimi Social i ka realizuar vizitat në familje të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë në strehim familjar, fëmijë në kujdestari, ka marr pjesë në intervistimin e të miturve në polici, ka marr pjesë në seanca gjyqësore, si dhe ka realizuar vizita tjera në familje të ndryshme ku është paraqitur nevoja e ofrimit të shërbimeve sociale.

### Me poshtë e keni raportin e sektorit të Shërbimeve Sociale në mënyrë tabelore

Nr.	Shërbimet e kryera	Numri i rasteve të reja	Numri i rasteve aktive (ekzistuese)	Vërejtje
1	Kujdestari për fëmijë	3	21	



	Kujdestari për raste të veçanta	2	8	
2	Delikuencë	9	0	
3	Adoptime – Periudhë provuese për Adoptim	0	0	
4	Dhunë në familje	18	11	
5	Strehim familjar brenda familjes biologjike/nr fëmijëve	3	11	
6	Strehim në shtëpinë e sigurt në Pejë	8	0	
7	Vendosje të fëmijëve në SOS fshatin e fëmijëve në Prishtinë	0	2	
8	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	4		
9	Çrregullime familjare	11		
10	Strehim në shtëpinë e sigurt në Gjakovë	0	0	
11	Përcjellje të kontaktit fëmijë-prind	9	6	
12	Shkurorëzime	10		
13	Fëmijë nga prindërit e shkurorëzuar	6		
14	Strehim i të moshuarve në shtëpinë e pleqve në Gurakoc dhe Skenderaj	0	4	
15	Vërtetime dhe deklarata	542		
16	Fëmijë më nevoja të veçanta	10	52	
17	Pjesëmarrje në seanca gjyqësore	49	2	

### Spektori i Asistencës Sociale

Në periudhën që po raportojmë, numri i familjeve shfrytëzueses të Ndhmës Sociale në të dy kategoritë është 908.

Gjithashtu, gjatë periudhës që po raportojmë në bashkëpunim më Kuvendin Komunal, Organaiztata humanitare, bizneset e ndryshme, Organizatat jo Qeveritare etj, i kemi ndihmuar rreth 1.500 familje me pako të ndryshme (higjienike, ushqimore, veshmbathje), lende djegëse (dru), kupona për gjera ushqimore e higjienike, mjete bujqësore, etj.



Me poshtë e keni raportin e sektorit të Asistencës Sociale në mënyrë tabelore për periudhën raportuese:

Aktivitetet	Kategoria I	Kategoria II	Gjithsej
Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë	38	85	123
Sa prej tyre janë të aprovuara	26	45	71
Sa prej tyre janë të refuzuara	9	36	45
Sa janë në shqyrtim	3	4	7
Numri i rasteve të dërguara në Komision mjekësor	85	0	85
Numri i rasteve të aprovuara nga KM	77	0	77
Numri i rasteve të refuzuara nga KM	8	0	8
Numri i rasteve të kthyer nga KM për kompletim dokumentacioni	0	0	0
Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e As. Sociale	2	2	4
Në shkallë të parë ( I )	1	1	2
Në shkallë të dytë ( II )	1	1	2
Numri i ankesave të aprovuara	0	0	0



Numri i ankesave të refuzuara	2	2	4
Kontestet në Gjykata	0	0	0

### Realizimi i te hyrave nga tarifat administrative në Qendrës për Punë Sociale

Meqenëse, me rastin e ndryshimeve të Rregullores mbi Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, nga Kuvendi Komunal, ne si QPS, kemi propozuar që të tariforen disa nga vërtetimet që i lëshon ky Institucion, ju informojë që gjatë kësaj periudhe që po raportojmë, kemi arritur që të grumbullojmë një shumë të konsiderueshme të të hollave, të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e Komunës së Klinës. Në vazhdim në mënyrë të detajizuar i keni të hyrat që janë grumbulluar për periudhën Janar – Dhjetor 2021, nga tarifat që i lëshon Qendra për Punë Sociale:

Muaji	Përshkrimi	Vlera e taksës - Euro
Janar - Dhjetor 2021	Vërtetim që nuk i është marr ose kufizuar aftësia për te vepruar (për marrjen e lejes për armëmbajtje)	5,020.00 €
Janar - Dhjetor 2021	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës	1,900.00 €
Janar - Dhjetor 2021	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i Asistencës Sociale	126.00 €
		<b>Totali: 7,046.00€</b>

### Sfidat

- Sigurimi i një fondi për investime kapitale që ti bëjmë disa renovime brenda dhe jashtë objektit e QPS-së.
- Grumbullimi e të hyrave vetanake të mbledhura nga QPS, në një kod të veçantë buxhetor të Qendrës për Punë Sociale/Shërbime Sociale, mjete këto ku do mundë të shfrytëzoheshin për pagesat e punëtorëve që angazhohen jashtë orarit të punës/kujdestari, si dhe për nevoja tjera për ndihmë familjeve në nevojë sociale.
- Krijimi i një fondi të veçantë për ndihmë emergjente familjeve nevojtare.

### Përfundimi

Qendra për Punë Sociale, kujdeset për banorët e Komunës sonë në nevojë për shërbime sociale dhe Asistencë Sociale, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, dhe orientime tjera.

Shuma e të hollave që shpërndahen përmes këtij Institucioni brenda një viti kalendarik është rreth **1.2 milion Euro**, duke përfshirë këtu familjet përfituese të Ndihmës Sociale, familjet që kanë fëmijë më nevoja të veçanta si dhe familjet që kanë në strehim fëmijë pa përkujdesje familjare.

Konsiderojmë se, edhe për kundër disa sfidave, periudhën që po raportojmë e kemi përmbyll suksesshëm, krejt kjo falë punës së stafit të QPS-së, me punën dhe angazhimin e të cilëve është bërë realizimi i planit dhe detyrave të punës, gjithashtu falë edhe bashkëpunimit të mirë me DSHMS-në, DPSF-në, si dhe me Institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare.

Mbesim me shpresë që angazhimi dhe bashkëpunimi në vitin e ardhshëm do rritët, në mënyrë që të arrihet në plotësi realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave për vitin 2022.

Kryetari i Komunës:

Prof. Dr. Zenun Elezaj

